

**Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis -
politikat në nivel global, evropian
dhe lokal**

Realizimi kompjuterik
Valon Fetahu

PËRMBAJTJA

Pjesa e parë

Parathënia	7
Nocioni i VNM	9
Definicionet kryesore.....	13
Historiku i VNM.....	15
Qëllimet e VNM	18
Parimet e VNM-s.....	20
Parimet e themelore të VNM-s.....	20
Parimet operative të VNM.....	21
Fazat e procesit të VNM.....	24

Pjesa e dytë: Marrëveshjet mjedisore ndërkombëtare

për VNM.....	31
Konventa e ESPOO-s	31
Protokoli i Kievit për VSM.....	34

Pjesa III: Kërkesat e institucioneve

financiare ndërkombëtare.....	36
Kërkesat e Bankës Botërore.....	36
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.....	39
Banka Evropiane për Investime	40

Pjesa IV: Kërkesat e legjislacionit të BE

Direktiva e BE-s për VNM.....	41
Direktiva e BE-s për VSM.....	42

Pjesa V: Pjesmarrja e publikut në procesin

e VNM-s	45
Konventa e Aarhusit	45
Direktiva 2003/35/EC.....	47

Pjesa VI: Kërkesa e legjislacionit kosovar

për VNM.....	48
--------------	----

Pjesa VII: Dokumentat e përkthyerat

Konventa e ESPOO-s	51
Direktiva e VNM-s	77
Direktiva e VSM-s.....	107

VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNECE	United Nations Economic Commission for Europe
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
UNEP	United Nations Environment Program
ODEA	Operational Directive for Environmental Assessment
BE	Bashkimi Evropian
BB	Banka Botërore
EBI	European Bank for Investments
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development
UA	Udhëzim Administrativ

“Vlerësimi i ndikimit në mjedis, si instrument nacional duhet të ndërrmirret për aktivitetet e propozuara që pritet të kenë ndikime të dëmshme në mjedis” (Parimi i 17-të i Dekleratës së Rio-s 1992 mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm)

Parathënie

Vlerësimi i ndikimit në mjedis si praktikë ligjore ndërkombëtare ka filluar të zhvillohet në fund të viteve të 60-ta, ndërsa që për Kosovën paraqet një zhvillim të ri në apsktet e menaxhimit të mjedisit në vend. Kjo është edhe arsyeja që aktualisht një spektër shumë i ngushtë i njerzve është familjarizuar me konceptin dhe procedurat e VNM-s.

Qëllimi i këtij publikimi është që të kontribuojë ofrimit të njohurive bazë në terma shumë të kuptueshëm dhe praktik të procesit të VNM-s me të gjitha përparsitë dhe pasojat e tij dhe përfshirjes së publikut në këtë proces.

Publikim i dedikohet audiencës së gjërë duke u nisur që nga zyrtarët qeveritar mjedisor në nivel qendror dhe ate lokal, shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, e deri te ekspertët e pavarur dhe studentët e shkencave të mjedisit.

Në këtë publikim kemi elaboruar konceptin e përgjithsëm të VNM, një pasqyr historike të zhvillimit të tij, qëllimet dhe objektivat afatshkurta dhe afatgjata, parimet e përgjithshme. Një vëmendje e veçantë i është dhënë aspektit procedural dhe fazave të procesit.

Ndërsa që janë elaboruar edhe kërkesat e marrëveshjeve ndërkombëtare mjedisore lidhur me VNM: konventa e Espoo-s, Protokoli i Kievit për VSM, si dhd direktivat relavante për procesin e VNM në sitsemin e BE. Me kalimin e kohës paralelisht me polotësimin elegjislacionit në shtete por edhe atij ndërkobëtar ka ardhur deri te zhvillimi dhe forcimi gjithnjë e më i madh i kërkesave nga mekanizmat e mëdha financiar botëror si Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka

Evropiane për Investime etj. Thjeshtë për projekte investive që pritet të kenë ndiklime domethënëse në mjedis, nuk lejohen kredi pa analizimin e ndikimeve të pritshme në mjedis.

Pasi që është një proces ku mirren vendime, dhe është vendi më i mirë ku publiku mund të involvohet në procesin e vendimmarrjes për çështje mjedisore, një vëmendje e veçantë i është dhënë përfshirjes së publikut në proces të cilin e siguron Konventa e Aarhusit dhe një direktivë e posaqme e BE-s.

Sigurisht që edhe në Kosovë, duke parë rolin kyq të VNM-s për aktivizimin e mekanizmave relevant për mbrojtjen e mjedisit, është duke u plotësuar efektshëm ana legjislative e kësaj fushe, e cila duhet të përcillet edhe me implementim praktik.

Falënderojmë Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur KFOS për mbështetjen financiare të projektit dhe përgatitjes së këtij publikimi.

Falënderojmë Qendrën Rajonale të Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore- Zyra e Shqipërisë për bashkëpunimin e ngushtë në ofrimin e direktivave dhe konventave të përkthyer në gjuhën shqipe që gjenden në pjesën shtesë të publikimit.

Autori

1. Nocioni i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

Vlerësimi i ndikimit në mjedis¹ është një proces që kërkon të sigurohet që informacionet e hershme dhe adekuate janë ofruar mbi pasojat e pritshme mjedisore të projekteve zhvillimore, alternativat e mundshme si dhe masat për zbutjen e tyre. Në përgjithësi VNM është parakusht për vendimet që merren për të autorizuar ndërtimet, aktivitetet ose proceset e ndryshme. Procedura e VNM kërkon nga zhvilluesi ose pronari i biznesit të dorëzoj një dokument të shkruar organit vendim-marrës duke përshkruar ndikimet e mundshme ose të pritshme të veprimit të caktuar në mjedis.

VNM-ja, sistematikisht egzaminon përfitimet por edhe pasojat e kundërta të projekteve, dhe merr parasysh këto gjatë dizajnit të projektit. Me marrjen në konsideratë të efekteve mjedisore të projekteve qysh në planifikimin e projekteve, VNM-ja ka shumë përfitime si: mbrojtja e mjedisit, shrytëzimi optimal i resurseve natyrore etj. Poashtu VNM-ja e kryer drejt zvoglon konfliktet duke promovuar pjesmarrjen e komunitetit, informua vendim-marrësit dhe duke shtruar bazën për projekte të qëndrueshme në aspektin mjedisor.

Në kontekstin e BE-s, VNM është një procedurë që siguron që implikimet mjedisore të vendimeve janë marrë në konsiderim para se ato të jenë marrë². Prosesi përfshin një analizë të efekteve të pritshme në mjedis, duke i vënë ato efekte në një raport, ndërrmarrjen e konsultimeve të publikut në raport duke marrë në konsiderim komentet, si dhe raportin kur merret vendimi final si dhe informimin e publikut për vendimin e mëvonshëm.

Në përgjithësi, vlerësimi mjedisor mund të ndërrmerret për:

1. projektet individuale (diga, autostrada, fabrika, aeroporte etj) që është VNM; dhe

¹ Gilpin A. 1995 “ Environmental Impact Assessment (EIA): Cutting edge for the twenty-first century” Cambridge University Press

² <http://ec.europa.eu/environment/eia/home.htm>

2. planet, programet dhe politikat që është Vlerësimi strategjik mjedisor.

Një pasqyrë e ngjashmërive dhe dallimeve në procesin e vlerësimit mjedisor është parqitur në Tabelën 1.

Problemet e shkaktuara me procedurat a VNM-s projekt pas projekti, kanë rezultuar me zhvillimin e qasjes së VNM-s kumulative ose edhe më shpesh vlerësimet kumulative të efekteve. Vlerësimet kumulative të efekteve bazohen në njohjen e ndikimeve të zhvillimeve individuale që mund të ndërveprojnë me njëra tjetrën dhe kjo mund të shkaktojë efekte të kombinuara që mund të jenë të ndryshme në natyrë dhe shtrirje. Kështu nëse p.sh për plotësimin e nevojave nergjetike duhet të ndërtohen termocentrale dhe hidrocentrale në vazhdimsi dhe për secilpn të kryhet VNM e veçantë atëher më mirë është që të bëhet një vlerësim mjedisor i krejt strategjisë së zhvillimit të atij sektori në atë shtet. Kjo me kohë ka cuar deri te nevoja e zhvillimit të konceptit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Janë 3 qasje bazë se kur VSM duhet të ndërrmerret dhe ato janë:

1. Nëse nisma pritet të shkaktojë efekte të kundërta domethënëse mjedisore (ngjajshëm me shumë sisteme të VNM-s);
2. Nëse nisma pritet të ndikoj në numrin, lokacionet, llojet dhe karakteristikat e projekteve që do të jenë subjekt i VNM-s (p.sh ndërtimi i termocentraleve të mëdha, autostradave etj); dhe
3. Nëse nisma e caktuar e prek sektorin i cili është caktuar si prioritet mjedisor.

V N M	V S M
➤ Bëhet në fund të ciklit vendim-marrës	➤ Bëhet në fazat e hershme të ciklit vendim-marrës
➤ Qasje reaktive ndaj propozimit zhvillimor	➤ Qasja pro-aktive ndaj propozimeve zhvillimore
➤ Identifikon ndikimet specifike në mjedis	➤ Identifikon implikimet mjedisore dhe problemet e zhvillimit të qëndrueshëm
➤ Konsideron numër të caktuar të alternativave të arsyeshme	➤ Konsideron një spektër të gjërë alternativash
➤ Shqyrton efekteve kumulative	➤ Paralajmron herët efektet kumulative
➤ Nënvizon zbutjen dhe minimizimin e ndikimeve	➤ Nënvizon plotësimin e objektivave mjedisore dhe ruajtjen e sistemeve natyrore
➤ Perspektivë të ngushtë me shkallë të lartë detajesh	➤ Perspektivë të gjërë me shkallë të ultë detajesh, ofron një vizion dhe kornizë të përgjithshme
➤ Proces i definuar mirë me fillim e përfundim të qartë	➤ Proces në shumë faza, dyfishime komponentesh e përsëritje
➤ Fokusohet në standarde, trajton simptomet e dëmit mjedisor	➤ Fokusohet në qëndrueshmërinë, ndalet në burimet e dëmit mjedisor

Tab. 1 Ndryshimet në mes të VNM dhe VSM (Burimi: EIA Training Resource Manual, 2-nd Edition, UNEP 2002)

Praktikat në botë po tregojnë përditë, se një kombinim i mirë i dy proceseve: atij të VNM-s dhe të VSM-s si dhe implementimi i drejtë i dispozitave të tyre siguron një zhvillim ekonomik të harmonizuar me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe pa ndikime të mëdha në mjedis.

2. Definicionet kryesore

“**Autoriteti kompetent**”- autoritetin kombëtar ose autoritetet e përcaktuara nga një Palë përgjegjëse për zbatimin e detyrave të mbuluara nga kjo Konventë dhe/ose autoritetin apo autoritetet, të cilave u jep fuqi për marrjen e vendimeve në lidhje me një veprimtari të propozuar (Konventa e Espoos).

“**Projekt**” në bazë të fjalorëve bashkëkohor është një përpjekje e përkohshme e ndërmarrë për të krijuar një produkt ose shërbim të caktuar.

“**projekti**” në kuptimin e Direktivës së VSM-s nëkupton:

- ekzekutimin e punëve të ndërtimit, instalimeve ose skemave të tjera,
- ndërhyrje të tjera në rrethinat natyrore dhe në mjedis, duke përfshirë dhe nxjerrjen e burimeve minerale;

“**Vlerësimi**”- është një proces dokumentimi, zakonisht në terma të matshëm të njohurive, aftësive, qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë.

“**Ndikim**” nënkupton çdo pasojë mbi mjedisin të një veprimtarie të propozuar, duke përfshirë shëndetin, e njerëzve, sigurinë e tyre, florën, faunën, tokën, ajrin, ujin, klimën, peisazhin dhe monumentet historike ose struktura të tjera fizike apo ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve; gjithashtu përfshin pasojat mbi trashëgiminë kulturore ose kushtet ekonomiko-shoqërore që janë rezultat i ndryshimeve të këtyre faktorëve;

Vlerësimi i ndikimit të mjedisit” nënkupton një procedurë kombëtare për të analizuar ndikimin e mundshëm mbi mjedisin të një veprimtarie të propozuar;

“**Ndikim ndërkufitar**” nënkupton çdo ndikim, jo vetëm të një natyre globale, brenda zonës në juridiksionin e një Pale, të shkaktuar nga një veprimtari e propozuar, origjina fizike e të cilës ndodhet plotësisht ose pjesërisht brenda fushës së juridiksionit të një Pale tjetër;

“**publik**” është: një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, dhe në përputhje me legjislacionin ose praktikën kombëtare, shoqatat, organizatat ose grupet e tyre

“**publiku në fjalë**” është publiku i prekur ose që ka të ngjarë që të preket nga, ose i cili ka interes në procedurat vendimmarrëse mjedisore të cilave u referohet Neni 2(2) i Direktivës së VNM; për qëllim të këtij përkufizimi, organizatat jo-qeveritare që promovojnë mbrojtjen mjedisore dhe që plotësojnë të gjitha kërkesat e parashtruara në ligjin kombëtar, do të konsiderohen si organizma që kanë interes.

“**raporti mjedisor**” është pjesa e dokumentacionit të planit ose programit që përmban informacionin që kërkohet në nenin 5 dhe në Shtojcën I të Direktivës së VSM;

“**planet dhe programet**” në kontekstin e Direktivës së VSM janë planet dhe programet, ku përfshihen dhe planet dhe programet e bashkë-financuara nga Komunitetit Evropian, si dhe çdo modifikim i tyre të cilat janë subjekt i përgatitjes dhe/ose miratimit nga një autoritet në nivelin rajonal ose vendor, ose të cilat janë përgatitur nga një autoritet për miratim, nëpërmjet një procedure legjislative, nga Parlamenti ose Qeveria, dhe të cilat kërkohen nga dispozitat legjislative, rregullatore dhe administrative;

“**vlerësimi mjedisor**” është përgatitja e një raporti mjedisor, përgatitja e konsultimeve, dhe marrja parasysh e raportit mjedisor dhe e rezultateve të konsultimeve, në vendimmarrje dhe dispozitat e informacionit mbi vendimin në përputhje me Nenet 4-9 të Direktivës së VSM-s.

3. Historiku i procesit të VNM-s

Procesi i VNM-s si instrument ligjor ka historinë e vet që nga viti 1969 kur në SHBA u aprovua Akti Kombëtar për Politikën Mjedisore (NEPA- National Environmental Protection Act). NEPA përmbante kërkesën për ekzaminimin e implikimeve mjedisore të veprimeve të mëdha federale që mund të kishin ndikim të madh në mjedisin njerëzor. Edhe pse fusha e legjisacionit të VNM ishte dhe mbetet e ngushtë, nevoja për VNM u pranua nga legjislaturat e shumicës së shteteve në botë dhe kështu VNM filloi të zbatohet me të madhe në tërë botën. Kërkesat formale për VNM më pas u futën në legjisacionin e Japonisë (1972), Hong Kong (1972), Kanada (1973) Australi (1974) etj. Tani janë më tepër se 100 shtete në botë që e kanë rregulluar fushën e legjisacionit të VNM, që tregon një evoluim shumë të shpejt të kësaj problematike si pasojë e kuptimit të rëndësisë.

Në Evropë, vendet e para që e futën kërkesën për VNM ishin Gjermania (1975) dhe Franca (1976). Më vonë në vitin 1985 BE aprovoi direktivën për VNM 85/337/EEC e cila më vonë ndryshohet me Direktivën 97/11/EC.

Që prej atëherë ka pas një ngritje të vazhdueshme të numrit të shteteve të cilat e kanë plotësuar legjisacionin e VNM si një nga mekanizmat kryesor për menaxhimin e mjedisit (Fig.1)




Fig.1. Progresi i adoptimit të legjislacionit të VNM nga shtete të ndryshme gjatë periudhës 1969-1995 (57 shtete³)

Gjatë periudhës së viteve 1970-80 shumica e marrëveshjeve ndërkombëtare mjedisore e imponojnë nevojën e VNM për aktivitetet zhvillimor duke zgjeruar cdo herë e më shumë shtritjen e saj, si dhe shkallën e detajeve të kërkuara për vlerësim. Shumë prej tyre ishin marrëveshje mjedisore rajonale.

Gjatë viteve 90-ta definitivisht ngritet në nivel global problematika e VNM-s. Këtë mund ta lidhim me disa nga marrëveshjet kryesore të cilat e përfshijnë problematikën e VNM-s në kuadër të dispozitave të tyre. Kështu Parimi 17 i Deklaratës së Rio-s kërkon vlerësimin paraprak të aktiviteve potencialisht të dëmshme të aktiviteve mbrenda një shteti.

Parimi 17 shprehet: “Vlerësimi i ndikimit në mjedis si instrument kombëtar duhet të ndërrmarret për aktivitetet e propozuara që pritet të kenë efekte domethënëse të dëmshme në mjedis dhe që janë subjekt i vendimit nga ana e organit kompetent kombëtar”.

Konventa e Rio-s mbi diversitetin biologjik (1992) kërkon nga Palët e saj që të vendosin procedurat e duhura për VNM për projektet e tyre që pritet të kenë efekte të dëmshme në diversitetin biologjik, me

³ Nicholas A. Robinson, 1992, International Trends in Environmental Assessment, *Boston College Environmental Affairs Law Review*

synimin për të evituar ose minimizuar efektet e tilla kur është e mundshme si dhe të lejojnë pjesmarrjen e publikut në këto procedura (neni 14, pika a).

Edhe Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatik në nenin 4 bën thirrje për përdorimin e VNM-s si mjet për zvoglimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis. Ndërsa Kapitulli 22 i Agjendës 21 proklamon domosdoshmërinë e vlerësimit të ndikimeve në mjedis të aktiviteteve të caktuara.

4. Qëllimet e VNM-s

Ndër qëllimet kryesore të procesit të VNM janë:

- a. Informimi i vendim-marrsve me pasojat mjedisore eventuale të vendimit;
- b. Ofrimi informacioneve të mjaftueshme dhe mundësisë për pjesmarrjen e publikut të interesuar në vendim-marrje;
- c. Integrimi i çështjeve mjedisore në fushat tjera të vendim-marrjes;
- d. Obligimi i shtetit për masat që të mos shkaktojë ndikime ndërkuftare.

Në këtë kuadër dallohen objektivat afatgjat dhe afatshkurtra të procesit të VNM.


Objektiva afatgjata janë:

- evitimi i efekteve të mëdha, të pakthyeshme dhe të papranueshme për mjedisin
- sigurimi i një zhvillimi i cili bazohet në potencialet ekzistuese dhe resurseve të mjaftueshme bazë për projektin;
- mbrojtja e kapaciteteve asimiluese dhe regjeneruese të sistemeve natyrore duke mos e rrezikuar stabilitetin e tyre; dhe
- mirëqenia e shëndetit njerëzor, komunitetit dhe individëve si dhe të drejtat, vlerat dhe interesat e banorëve autokton m(indiogjen).

Objektivat afatshkurtra konsiderohen:

- mbështetja në vendim-marrje të informuar në lidhje me zhvillimin e projekteve si dhe alternativave adekuate;
- identifikimi, zbutja si dhe kompensimi i efekteve të dëmshme mjedisore nga ana e projekteve të propozuara;
- kontribut për dizajnim dhe planifikim më të mirë të projekteve dhe aktiviteteve në mënyrë që të mos bien në konflikt me legjislacionin si dhe me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm;

- Ofrimin e mundësisë për involvimin e publikut që do të jetë direkt i prekur nga projekti ose aktiviteti i propozuar, përfshirë edhe publikun e interesuar.



5. Parimet e VNM

5.1. Parimet themelore të VNM

Në përgjithësi VNM duhet të jetë një proces:

- **i qëllimshëm**- të informoj vendimmarrjen dhe rezultatet në nivele të caktuara të mbrojtjes së mjedisit;
- **rigoroz**- duhet të shfrytëzoj praktikën më të mira shkencore, metodologjitë dhe teknikat adekuate për të adresuar problemet që hulumtohen;
- **praktik**- procesi duhet të rezultojë me informata dhe rezultate që ndihmojnë në zgjidhjen e problemit, janë të pranueshme dhe mund të implementohen;
- **kost-efektiv**- procesi i VNM duhet të arrijë objektivat mbrenda kufijve të mundshme të kohës, informatave, resurseve dhe metodologjisë;
- **i fokusuar**- procesi duhet të koncentrohet në efektet domethënëse mjedisore dhe çështjet kyqe, d.t.th çështjet që duhen konsideruar gjatë marrjes së vendimit;
- **transparent**- procesi duhet të ketë kërkesa të qarta dhe lehtë të kuptueshme për përmbajtjen e VNM, siguroj qasjen e publikut në informim si dhe të identifikoj faktorët që duhen marrë në konsiderim në vendim-marrje;
- **adaptiv**- procesi të përshtatet me realitetin, çështjet dhe rrethanat e propozimit që shqyrtohet pa e cënuar integritetin e procesit, të mos ketë përsëritje duke inkorporuar mësimet e mësuara gjatë ciklit të projektit;
- **participativ**- procesi duhet të siguroj mundësin adekuate të informimin dhe përfshirjes së publikut të prekur dhe atij të interesuar, brengat e të cilëve duhet adresuar në mënyrë eksplicite në dokumentacion dhe vendim-marrje;
- **interdisciplinar**- procesi duhet të siguroj që të angazhohen teknikat dhe ekspertiza e duhur nga

diciplinat relavante (mjedisore dhe socioeknomike) përfshirë njohuritë tradicionale;

- **i besueshëm**- procesi duhet të zhvillohet në mënyrë profesionale, objektive dhe të balancuar, fer dhe të paanshme dhe të jetë subjekt i verifikimeve dhe kontrollimeve të pavarura;
- **i integruar**- procesi duhet të adresoj ndërveprimet e aspekteve sociale, ekonomike dhe mjedisore;
- **sistematik**- procesi duhet të rezultoj në konsiderimin e plotë të informacionit relavant të mjedisit të prekur, alternativave të propozuara dhe ndikimin e tyre, si dhe masat për monitorimin dhe hulumtimin e efekteve të mpëasme.

5.2 Parimet operative të VNM⁴

VNM duhet *të aplikohet* për:

- projektet dhe aktivitetet që pritet të shkaktojnë ndikime në mjedis;
- si instrument primar për menaxhimin e mjedisit të siguroj që ndikimet e zhvillimeve të ndryshme të minimizohen, evitohen ose rehabilitohen;
- fusha e shqyrtimit të jetë në pajtim me natyrën e projektit ose aktivitetit dhe ballafaqimin me problemet dhe ndikime e pritshme; dhe
- në bazë të roleve dhe përgjegjësive të definuara të akterëve kyq në proces.

⁴ Sadler, B & K Brown 1999 "Principles of EIA best practice" UK Release, Environmental Assessment 7,2 pp. 40-41

VNM duhet të ndërrmirret:

- përgjatë tërë ciklit të projektit, duke filluar sa më herët që të jetë e arsyeshme në fazën e dizajnit të projektit;
- me referenca të qarta të kërkesave për autorizimin e projektit dhe përcjelljen duke përfshirë menaxhimin e ndikimeve;
- konsistent në aplikimin e “praktikave më të mira” shkencore dhe teknologjike;
- në pajtim me procedurat e vendosura, specifikat e projektit përfshirë oraret kohore;
- të ofroj mundësi adekuate për involvimin e publikut, komunitetit, grupeve dhe palëve të ndikuara direkt ose me interes në projektin ose ndikimet e tij mjedisore.

VNM duhet të adresoj kur është e domosdoshme dhe adekuate:

- faktorët e tjerë relavant përfshirë ndikimet sociale dhe ato në shëndet;
- efektet kumulative dhe afatgjata dhe ato të mëdhat;
- alternativat e dizajnit, lokalitetit dhe teknologjisë të propozimit;
- konsideratat e qëndrueshmërisë përfshirë: produktivitetin e resurseve, kapacitete asimiluese dhe diversitetin biologjik.

VNM duhet të rezultojë me:

- informata të sakta dhe adekuate për natyrën, madhësinë e pritshme dhe shkallën e efekteve potenciale, rreziqeve si dhe pasojat e ndërrmarrjes së propozuar si dhe alternativat;
- përgatitjen e një raporti/studimi të VNM që prezenton informacione të qarta dhe të kuptueshme si dhe relavante për marrjen e vendimit;

- raporti/studimi i VNM të identifikoj kufijtë e besueshëm që mund të vendosen në parashikim dhe qartësoj fushat e pajtimit ose mospajtimit mes palëve të involvuara në proces.

VNM duhet të ofroj bazë për:

- vendimarrjen mjedisore “*environmentally sound*” në të cilin kushtet janë qartësisht të dhëna dhe të detyrueshme;
- dizajnimin, planifikimin dhe ndërtimin e projektit zhvillimor të pranuar që përmbush standardet dhe objektivat menaxhuese;
- një proces përcjelljeje me kërkesat për monitorim, menaxhim, auditim dhe vlerësim;
- kërkesa përcjelljeje që bazohen në shkallën e efekteve potenciale, si dhe paqartësitë që shoqërohen me parashikimin dhe zbutjen e tyre;
- mësim nga përvojat me synimin për të bërë përmirësime në të ardhmen për aplikimin e procesit të VNM.

6. Fazat e procesit të VNM-s

Në përgjithësi procesi i VNM-s kalon nëpër 8 faza.

1. Përzgjedhja- është faza e parë e VNM, në të cilin autoriteti kompetent përcakton nëse projekti i propozuar duhet t'i nënshtrohet procesit të VNM dhe nëse po atëherë çfarë lloji i VNM nevojitet. Në legjislacionit tonë këtu nënkuptohet nëse duhet VNM, e nëse po atëherë a duhet ajo VNM të jetë e plotë ose e thjeshtë.

Në parim të gjitha projektet duhet t'i nënshtrohen procesit të VNM. Është e rëndësishme që vendimi të merret sa më herët që është e mundshme lidhur me fushën e shtrirjes së VNM-s e cila nevojitet, pasi që edhe aplikuesi më shpejt të procedoj.

Sistemi më i zakonshëm (por jo universal) i kategorizimit të projekteve që duhet t'i nënshtrohen procesit të VNM-s i klasifion ato në:

- **Projektet e kategorisë 1-** janë projektet që nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të kundërt dhe të cilat nuk kërkojnë ndonjë studim shtesë mjedisor.
- **Projektet e kategorisë 2-** janë projekte që pritet të shkaktojnë numër të kufizuar ndikimesh të kundërta përderisa nuk ndërmerren masa adekuate zbutëse. Projektet e tilla mund të implementohen pas një studimi të kufizuar mjedisor dhe përgatitjes së një plani për zbutjen e ndikimeve. Për këto projekte problemet mjedisore që kërkojnë vëmendje janë më të vogla dhe natyra e tyre mund të vlerësohet më lehtë.
- **Projektet e Kategorisë 3-** projektet që pritet të shkaktojnë një sere ndikime domethënëse të kundërta, shtrirja dhe madhësia e të cilave nuk mund të dihen pa u bërë një vlerësim detal mjedisor. Për projektet e tilla duhet përgatitur një raport detal dhe gjithpërfshirë I VNM-s. Ngjajshëm masat për zbutja nuk sajohen para se të sigurohen rezultatet e këtij studimi.

Disa projekte të cilat kanë qëllime mjedisore si psh. ripyllëzimi, ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujrave të zeza, shpesh mund të kenë ndikime të padëshiruara nëse nuk mirren masa adekuata. Projektet e tilla nuk duhet që automatikisht të kategorizohen në Kategorinë 1 para se të konsiderohen shkalla dhe kufijtë e efekteve të pritshme.

2. Shtrirja e fushës së studimit (scoping)- është hapi i ardhshëm dhe kritik paraprak për të identifikuar efektet e dëmshme, dhe të vendos për termat e referencës për VNM të detajuar si dhe alternativat për tu konsideruar. Në këtë fazë identifikohen çështjet themelore dhe ndikimet që duhen hulumtuar më tej në lidhje me projektin që mund të përmbliidhen në dy grupe:

1. Projekt-propozimi dhe alternativat e tij (përfshirë opcionin “no action”) dhe
2. Efektet e pritshme që duhet të hulumtohen

Në këtë fazë definoen edhe kufijtë si dhe koha e studimit. Njoftohen të gjithë rol-luajtësit në proces që në parim janë:

- i. Ministrinë relavante të qeverisë (psh. bujqësisës, transportit, resurseve natyrore, shëndetsisë etj);
- ii. Autoritetet lokale në territorin e të cilav do zhvillohet projekti (komunat)
- iii. Organizatat e sektorit privat: odat ekonomike, shoqatat tregtare etj;
- iv. Organizatat joqeveritare dhe
- v. Përfaqësuesit e publikut të prekur

Në shumë raste kjo është faza e hartimit të termave të referencës për VNM në lidhje me projektin. Edhe pse të fiskuara termat e referencës nuk janë rigjide dhe mund të rishikohen në bashkëpunimin trepalësh: zhvilluesi/aplikuesi, eksperti i VNM dhe autoriteti kompetent.

3. Analiza e ndikimeve- në këtë fazë hulumtohen, identifikohen dhe parashikohen ndikimet e pritshme mjedisore dhe sociale të projektit të propozuar si dhe

vlerësohet shkalla e tyre. Parmimisht VNM duhet të bazohet në parashikimet dhe vlerësimet e secilës alternativë të projektit të ndikimeve të identifikuara në fazën e përcaktimit të fushës së shtrirjes (copingut). Ato alternativa duhet të krahasohen me njëra tjetrën si dhe me opcionin “no action” (pa vepruar).

Në fazën e analizës së ndikimeve duhet marrë parasysh: ndërveprimet e projektit me mjedisin, ndërveprimet sociale me mjedisin dhe zhvillimet sekondare të projektit.

4. Zbutja e ndikimeve- është faza e procesit ku rekomandohen veprimet për të zvogluar dhe evituar pasojat potenciale të aktiviteteve zhvillimore. Poashtu bëhet specifikimi i masave për të parandaluar, minimizuar dhe mënjanimin ose kompensimin e dëmeve dhe humbjeve mjedisore.

Secila VNM duhet të përmbaj planin për menaxhimin e ndikimeve, pasi që projektit duhet të menaxhoj ndërveprimet e tij me mjedisin. Mirëpo pasi që VNM është një proces parashikues, dhe pasiguritë në të shpesh mund të kenë rezultate të papritura, të cilat megjithatë projekti duhet të bëjë të gjitha që të mos ndodhin.

Procesi i menaxhimit të ndikimeve ka tri faza kryesore:

1. implementimi i masave zbutëse;
2. monitorimi/vlerësimi i tyre; dhe
3. ndryshimi i planit (që varet nga rezultatet e fazës së monitorimit/vlerësimit).

Menaxhimi i ndikimeve kërkon shumicën (në mos të gjitha) e këtyre elementeve:

- ✓ Masat zbutëse;
- ✓ skemat e monitorimit;
- ✓ planet e zhvendosjes (në raste emergjent të shkarkimeve të ndotësve);
- ✓ ndërlidhja me agjencinë shtetore për kontrollin e ndotjes, ministrinë respektive, dhe përfaqësuesit e komunitetit lokal; dhe

- ✓ ku është e nevojshme implementimi i një sistemi të auditimit mjedisor.

Sa u përket masave zbutëse ato mund të ndahen në disa lloje si:

1. Parandalimi ose minimizimi i ndikimeve para se ato të ndodhin;
2. Eliminimi ose zvoglimi i një ndikimi aktual;
3. Korrigjimi i një ndikimi duke riparuar, rehabilituar ose ripërtrirë mjedisin e ndikuar;
4. kompensimin për ndikimi;
5. Rritja maksimal e ndikimeve përfituese përmes veprimeve shtesë.

Monitorimi i ndikimeve përbëhet nga 3 lloje:

- i. Monitorimi i përmbushjes (p.sh. sasia dhe përbërja e rrjedhave të ndotjes)
- ii. Monitorimi i zbutjes- nëse masat zbutëse janë implementuar në pajtim me orarin e pritur; dhe
- iii. Monitorimi i ndikimeve (shkalla dhe shtrirja e ndikimeve të shkaktuara nga projekti).

5. Raportimi- prezenton rezultatet e VNM në formën e raportit të VNM të përgatitur në emër të aplikuesit, për vendim-marrësit (agjencinë shtetërore, ministrinë) dhe palëve tjera të interesuara. Raporti i VNM në shtete të ndryshme hartohet nga persona fizik ose juridik të specializuar dhe me ekspertizë për këtë veprimtari (zakonisht të pajisuar me liçenca përkatëse për kryerjen e saj). Hartuesi i Raportit së bashku me aplikuesin e bartin përgjegjësinë për kualitetin e të dhënave.

Në përgjithësi, kërkesat minimale të një raporti duhet të përmbajnë seksionet si më poshtë:

- ✓ Përmbledhja ekzekutive ose joteknike
- ✓ Hyrja
- ✓ Përshkrimi i qëllimeve të projektit
- ✓ Diskutimi i marrëdhënieve të projektit të propozuar me politikat tjera të zonës së zhvillimit;

- ✓ Përshkrimi i projektit dhe alternativat (përfshirë atë “no action”);
- ✓ Përshkrimi i kushteve mjedisore në kohën e parashikuar të implementimit të projektit;
- ✓ Vlerësimi i ndikimeve të secilës alternativë, me informata për kriteret e përdorura për vlerësim;
- ✓ Vlerësimi krahasues i alternativave, përfshirë ndikimet e kundërta dhe ato përfituese;
- ✓ Planin për menaxhimin e ndikimeve;
- ✓ Diskutimi i pasigurive në baza të parashikimeve dhe mungesës së të dhënave në raport;
- ✓ Shtojcat (i gjithë informacioni teknik i përdorur për hartimin e raportit: fjalorthi, lista e akronimeve, referencat e përdorura; emrat e anëtarëve të ekipit përpilues të raportit dhe termat e referencës).

6. Shqyrtimi i VNM- egzaminon saktësinë dhe efektivitetin e të raportit të VNM dhe ofron informacionet e domosdoshme për vendim-marrësit. Qëllimi kryesor i kësaj faze është që të kontrolloj në mënyrë kritike nëse janë përmbush kriteret në vijim:

- Përgjigje e plotë në kërkesa e termave të referencës (ToR);
- Përmbledhja jo ekzekutive (joteknike) është e bashkangjitur;
- Situata e “*no action*-pa veprim” është përshkruar në mënyrë adekuate;
- Konteksti i politikave planifikuese të zonës së propozuar është përshkruar dhe dokumentuar;
- Efektet e kundërta domethënëse dhe ato përfituese janë identifikuar, përshkruar me arsyetimin e domethënies;
- Alternativat janë vlerësuar barabartë dhe janë krahasur mes vete;

- Alternativa e preferuar mjedisore është identifikuar dhe me arsyetime për këtë;
- Të gjithë rol-luajtësit kanë qenë të involvuar në proces;
- Burimet e të dhënave të identifikuara qartë dhe të referuara;
- Metodot dhe teknikat specifike për parashikimin dhe vlerësimin e ndikimeve janë përshkruar dhe kufizimet në të dhëna janë identifikuar.

Në raste kur raporti nuk është i plotë teknikisht, agjencia përgjegjëse mund të kërkoj punë shtesë e cila duhet të sigurohet nga aplikuesi. Pas kësaj raport mund të përcillet për vendimarrësit për marrjen e vendimit.

7. Marrja e Vendimit- është faza në të cilin autoriteti kompetent vendos për aprovimin, refuzimin ose nevojën për ndryshime të tjera. Në shumicën e praktikave vendimi për pëlqim zakonisht përmban edhe kushte të caktuara nën të cilat lëshohet pëlqimi.

8. Monitorimi pas procesit- aplikohet pas fillimit të projektit. Kjo fazë kontrollon që të sigurohet që ndikimet e projektit të mos kalojnë standardet ligjore dhe implementimin i masave zbutëse të bëhet ashtu si është përshkruar në raportin e VNM-s dhe në vendimin për dhënien e pëlqimit mjedisor.

Kërkesat e marrëveshjeve ndërkombëtare mjedisore



7. Konventa e ESPOO-s për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekst ndërkufitar

Konventa e ESPOO-s (*The Convention on Environmental Impact Assessment in a Transboundary Context*) u adoptua në qytetën Espoo të Finlandës me 25 shkurt 1991⁵. Kjo Konventë përcakton detyrime dhe obligime Palëve që të vlerësojnë ndikimin ndërkufitar⁶ në mjedis të aktiviteteve të caktuara qysh në fazat e hershme të planifikimit. Ajo gjithashtu hap rrugën për obligimet e përgjithshme të shteteve që të njoftojnë dhe të konsultojnë njëra tjetrën për të gjitha projektet e mëdha që konsiderohen se do të shkaktojnë ndikim të dukshëm mjedisor përtej kufijve. Konventa ka hyrë në fuqi me 10 shtator 1997. Një amandament në Konventë është adoptuar në vitin 2001 e i cili pas hyrjes në fuqi u hap rrugën për qasje në Konventë edhe vendeve që nuk janë anëtare të UNECE, pas aprovimit nga ana e KB. Amandamenti i dytë në Konventë është aprovuar në vitin 2004 dhe tashmë në fuqi do të: lejojë kur është e nevojshme që Palët e ndikuara të marrin pjesë në procesin e përzgjedhjes; ndërmarrin masat e pëlqimit; dhe ndryshojnë Shtojcën I (Listën e aktiviteteve);

Konventa ka 20 nene dhe 7 shtojca.

⁵ <http://www.unece.org/env/eia/>

⁶ “ndikim ndërkufitar”- cdo ndikim, jo me natyrë globale, mbrenda territorit nën juridiksion të një Pale, e shkaktuar nga aktiviteti i propozuar, burimi i të cilit ndodhet në tërë apo në pjesë të caktuar të territorit nën juridiksionin e një Pale tjetër (neni 1).

- 1) Rafineritë bazë të derivateve;
- 2) Stacionet termo dhe hidroenergjetike;
- 3) Trajtimi, magazinimi dhe deponimi i mbeturinave radioaktive
- 4) Shkretoret e hekurit e celikut,
- 5) fabrikat e azbestit,
- 6) impiantet kimike;
- 7) Ndërtimet e rrugëve të mëdha dhe hekurudhave;
- 8) Tubacionet e derivateve dhe gazit;
- 9) Portet;
- 10) Deponimi i mbeturinave toksike dhe të rrezikshme;
- 11) Digat dhe rezervoaret e mëdha;
- 12) Nxjerrja e ujrave nëntoksor;
- 13) Përpunimi i mishit dhe letrës;
- 14) Minierat e mëdha;
- 15) Prodhimi i derivateve në det të hapur;
- 16) Magazinimi i derivateve dhe kimikateve; dhe
- 17) Shpyllëzimet e mëdha.

Tab. Xx Lista e projekteve të mbuluara nga Konventa e ESPOO-s

Shtojca I përmban listën e aktiviteteve që i nënshtrohen VNM, Shtojca II përmban dokumentacionin që kërkohet, Shtojca III përmban kriteret e përgjithshme, Shtojca IV përmban procedurat e verifikimit, Shtojca V përmban analizat e pas-projektit, Shtojca VI përmban elementet e bashkëpunimit dhe Shtojca VII përmban arbitrazhin.

Organet e Konventës janë:

Takimi i Palëve (neni 11) përbëhet nga këshilltarët e qeverive të vendeve të UNECE-s dhe përcjell implementimin e Konventës përmes: shqyrtimit të politikave dhe metodologjive të VNM-s nga Palët;

shkëmbimin e përvojave në vendosjen e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale ndërmjet Palëve; dhe kërkoj sipas nevojës këshillat e organeve ndërkombëtare dhe komisioneve shkencore në metodologjitë dhe teknikat lidhur me qëllimet e Konventës.

Sekretariati- ofrohet nga Sekretari Egzekutiv i UNECE-s. Sekretariati aranzhon mbledhjet e Takimit të Palëve, përcjell informatat dhe raportet e pranuar.

8. Protokoli për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (SEA Protocol)

Konventa e Espoos u pasua nga Protokoli mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor (*Protocol on Strategic Environmental Assessment*⁷- SEA) që u adoptua dhe u hap për nënshkrim në Konferencën ministrore “Mjedisi për Evropën” në Kiev të Ukrainës më 21 maj 2003. Edhe pse e negociuar nga UNECE, Protokoli do të jetë i hapur për të gjithë anëtarët e OKB.

Protokoli kërkon nga Palët e tij që të vlerësojnë konsekuencat e planeve dhe programeve të tyre zyrtare. Protokoli gjithashtu ofron një pjesëmarrje të gjërë publike në vendimarrjen e qeverisë dhe në shumë sektorë zhvillimor.

Procesi i VSM, në vendim-marrje ndërrmerret shumë më herët se sa VNM, dhe si e tillë është parë si mjete kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Protokoli lejon identifikimin dhe parandalimin e ndikimeve të mundshme mjedisore që nga fillimi i procesit të vendimarrjes, duke zhvilluar politika më të qëndrueshme të transportit se sa minimizimin e ndikimeve mjedisore në ndërtimin e rrugëve, dhe mundëson që objektivat mjedisore të konsiderohen së bashku me ato socio-ekonomike, duke e sjell zhvillimin e qëndrueshëm më afër.

Protokoli ofron një pjesëmarrje të gjërë të publikut në vendimarrjen qeveritare në një numër sektorësh zhvillimor që nga planifikimi i shfrytëzimit të tokës deri te transporti, nga bujqësia tek industria, duke mbuluar që nga rafineritë e naftës deri te ski liftet. Publiku nuk do të ketë vetëm të drejtën për të ditur për planet dhe programet, por edhe të drejtën që komentet e tij të merren në konsideratë, si dhe të njoftohet për vendimin që merret dhe arsyet se pse vendimi është marrë. Përveq se merr në konsideratë efektet tipike mjedisore të planeve dhe programeve.

Protokoli i ka 26 nene dhe 5 shtojca. Shtojca I përmban listën e programeve dhe planeve që duhet ti

⁷ <http://www.unece.org/env/eia/documents/protocol-english.pdf>

nënshtrohen procesit të VSM në bazë të nenit 4 p.2. Shtojca II përmban listën e projekteve lidhur me nenin 4 paragrafi 2 që duhet t'i nënshtrohen procesit të VNM, në bazë të legjislacionit nacional.

Shtojca III- përcakton kriteret për përcaktimin e efekteve të rëndësishme mjedisore përfshirë ato shëndetsore. Shtojca IV përcakton informatat që duhet të egzistojnë në raportin mjedisor që duhet përgatitur nga cdo Palë për planet dhe programet subjekte të VSM në (neni 7, p. 2). Shtojca. V rregullon procedurën e informimit të public në procesin e VSM.

Kërkesat e institucioneve financiare ndërkombëtare

9. Kërkesat e Bankës Botërore për vlerësim të ndikimit në mjedis



Gjatë viteve të 80-ta Banka Botërore (BB) filloj të shqyrtoj implikimet mjedisore të veprimtarive të veta dhe krijoi nga një departament mjedisor në të 4 divizionet e veta. Në vazhdim të këtyre përpjekjeve për konsiderimin e im plikimeve mjedisore, me 1989 BB nxori Direktivën Operacionale të Ndikimit në Mjedis⁸-ODEA (ndryshuar me 1991⁹). Vlerësimi sipas direktivës mbulon projektet specifike dhe ndikimet tjera që mund të shkaktohen nga projektet. Qëllimi i Direktivës ishte që opsionet e projekteve në konsiderim të jenç të qëndrueshme dhe sa më mjedisore¹⁰. Të gjitha pasojat mjedisore duhet të njihen që në fazat e hershme të ciklit të projektit dhe të konsiderohen gjatë zgjedhjes, lokacionit, planifikimit dhe dizajnit të projektit. Poashtu vlerësimi duhet të identifikoj mënyrat për përmirsimin e projekteve për parandalimin, minimizimin dhe kompensimin e efekteve të dëmshme mjedisor.

ODEA ndan vlerësimet mjedisore sipas: projekteve, rajoneve dhe sektorëve ku aktivitete zhvillimore të ngjajshme por domethënëse planifikohen për një zonë të caktuar, për kredi investive sektorale dhe kredi përmes ndërmjetsuesve, projekte emergjente të ripëtrirjes, dhe problemet e mëdha siq janë hollimi i shtresës së ozonit ose ndotja e ujrave ndërkombëtar.

⁸ World Bank Operational Directive 4.00 (1989) www.worldbank.org/oed/oeddoelib.nsf/

⁹ Ky ndryshim e fuqizon më tepër pjesmarrjen e publikut duke kërkuar nga qeveritë huamarrëse të konsideroj pikëpamjet e grupeve të prekura dhe OJQ-ve.

¹⁰ Guidance on sustainability is provided in OMS 2.36, *Environmental Aspects of Bank Work*.

Përgatitja e vlerësimit të ndikimit është përgjegjsi e huamarrësit, por BB e ndihmon dhe mbikqyr projektet në mënyrë që të përzgjedh dhe përcakton natyrën dhe volumin e punës mjedisore që duhet bërë.

Sipas ODEA-s shqyrtimi mjedisor fillon me identifikimin e seriozitetit të dëmit të mundshëm. Banka përzgjedh të gjitha projektet dhe secilën prej tyre, varësisht prej karakterit, dimensioneve dhe ndjeshmërisë e vendos në një të një të një prej 4 kategorive më poshtë:

Kategoria A – projektet që mund të kenë ndikim të madh në mjedis dhe që kërkojnë VM të plotë. Të tilla janë: digat dhe rezervoaret; prodhimi pyjor; impiantet e mëdha industriale; ujitja, drenazhimi, dhe kontrolli i vërshimeve; pastrami dhe nivelimi i tokës; zhvillimet minerare; zhvillimi i porteve dhe limaneve; bonifikimi dhe zhvillimi i tokave të reja; zhvendosja dhe të gjitha projektet me ndikim potencial në njerëz; zhvillimet në bazenet ujore; ndërtimi i hidro dhe termocentraleve; dhe përpunimi, transportimi dhe përdorimi i pesticideve dhe materieve tjera hazarde ose toksike (Shtojca E).

Kategoria B – projektet që mund të kenë efekte specifike mjedisor të kufizuar i cili duhet të hulumtohet por që nuk kërkon domosdoshmërisht një vlerësim të thellë mjedisor¹¹. Për projektet e tilla zakonisht mjafton një Plan për menxhimin mjedisor (i cili plan përgatitet edhe për projektet e Kategorisë A si pjesë e VNM së plotë).

Kategoria C – projektet për të cilat një analizë mjedisore normalisht nuk është e domosdoshme¹².

¹¹ Aktivitetet që listohen në Shtojcën E si aktivitete të kategorisë B janë: agro-industritë e vogla; transmisionet elektrike, akuakultura dhe marikultura, drenazhimet dhe ujitjet në shkallë të vogël, energjia e ripërtrishme, elektrifikimi i zonave rurale, turizmi, ujitja dhe kanalizimi në zonat rurale, projektet e ujdarsve ; si dhe projektet e vogla të rehabilitimit, përkujdesjes dhe përmirsimit.

¹² Aktivitetet që listohen në Shtojcën E si projekte të kategorisë C janë: edukimi, planifikimi i familjes,

Kategoria D – projektet mjedisore për të cilat nuk kërkohet vlerësim pasi që zhvillimi i mjedisit është fokus i tij dhe për të cilin supozohet se pasojat mjedisore vec janë konsideruar.

Vlerësimi mjedisor sipas BB duhet të jetë pjesë e studimit të fizibilitetit ose përgatitjes së projektit dhe duhet ti dorëzohet Bankës e cila vendos për kredinë.

Banka pret nga huamarrësi të koordinoj ndërmjet agjensive qeveritare dhe të marrë pikëpamjet e grupet e prekura si dhe OJQ-ve duke siguruar informacioni e nevojshëm për ta dhe duke i konsultuar.

10. Kërkesat e institucioneve financiare evropiane

10.1. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (European Bank for Reconstruction and Development- EBRD)



EBRD¹³ është themeluar në vitin 1991 dhe përdor investimet për të ndihmuar zhvillimin e ekonomisë së tregut dhe demokratizimin në 27 vende që nga Evropa qendrore deri në Azinë qendrore.

Dokumenti i Politikave Mjedisore të EBRD-s kërkon që të gjitha investimet dhe aktivitetet e bashkëpunimit teknik duhet t'i nënshtrohen vlerësimit mjedisor (*environmental appraisal*) si pjesë e kujdesit financiar, ekonomik, ligjor dhe teknik. Ky vlerësim mjedisor duhet të inicohet që në fazat e hershme të projektit. Banka përcakton llojin e vlerësimit që duhet bërë dhe njëkohsisht ofron udhëzimet e nevojshme¹⁴ se si duhet kryer ai vlerësim. Sponzorizuesi i projektit është përgjegjës që t'i ofroj EBRD-s informacionet e nevojshme duke përgatitur një Plan të Veprimit në Mjedis, i cili bëhet pjesë e dokumentacionit ligjor të investimit të Bankës. Në emër të EBRD-s, udhëheqësi i operacioneve ka përgjegjësinë e përgjithshme për aspektet mjedisore të operacionit, dhe së bashku me Zyrën e Konsullit të Përgjithshëm inkorporon kërkesat mjedisore në dokumentacionin ligjor.

Vlerësimi mjedisor i EBRD përfshin jo vetëm VNM-n paraprake por edhe Auditimin Mjedisor i cili identifikon brengat e kaluara dhe të tashme mjedisore dhe shëndetsore, sigurinë nga rreziqet si dhe përgjegjësinë që lidhet me projektin.

¹³ <http://www.ebrd.com/>

¹⁴ *Principles of Action* adopted by the E.B.R.D. March 1992, document ML057

10.2. Banka Evropiane për Investime (European Bank for Investments¹⁵)



Banka Evropiane për Investime (EBI) është organ financiar i BE-s që financon projekte afatgjata në rajonin e shteteve të Afrikës, Karaibeve dhe Paqësorit si dhe të Evropës Qendrore dhe Lindore. Edhe pse ka një autonomi të veten mbrenda BE-s, EBI vepron në pajtim me legjislacionin mjedisor të BE-s dhe aplikon kërkesat e Direktivës 85/337/EEC për VNM. EBI merr pjesë aktive në identifikimin e reziqeve potenciale të projekteve dhe masa adekuate për zbutjen e tyre. Huamarrësi duhet të përgatis një VNM i cili duhet të përcillet me konsultimin e publikut. Gjatë përzgjedhjes së projektit, EBI mund të kërkojë futjen në kontratën e kredisë të dispozitave adekuate që garantojnë mbrojtjen e mjedisit. EBI gjithashtu mund të ndërtojë si konsultant në çështjet mjedisore dhe financojë identifikimin dhe përgatitjen e projekteve për përmirsimin e mjedisit.

¹⁵ <http://www.eib.org/>

11. Direktivat e BE-s për VNM

Komisioni Evropian, çështjen e adresimit të VNM e ka ngritur në Programin e dytë të Veprimit Mjedisor në vitin 1977. Edhe pse e inicuar mjaft herët, pati kundërshtime të shumta. Komisioni kështu ndërmjet viteve 1977-1980 prodhoi rreth 20 drafte interne para se formalisht ta propozoj Direktivën me 1980.

11.1. Direktiva 85/337/EEC

Direktiva **85/337/EEC**¹⁶ mbi vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuar publike ose private në mjedis është sjellë me 1985 dhe ndryshuar me 1997. Direktiva kërkon që para se të jepet pëlqimi mjedisor nga qeveria për projektet e tilla, duhet që të bëhet një vlerësim i efekteve potenciale mjedisore.

Direktiva mishëron qasjen parandaluese të mbrojtjes së mjedisit duke kërkuar që para se organi qeveritar të jep pëlqimin në projekt, të bëhet një identifikim dhe vlerësim i efekteve potenciale të atij projekti në mjedis.

VNM do të identifikojë, përshkruajë dhe vlerësojë në mënyrën e duhur, në kuadrin e çdo rasti individual, dhe në përputhje me nenet 4 dhe 11, efektet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të një projekti mbi bazën e faktorëve të mëposhtëm:

1. qëniet njerëzore, fauna dhe flora;
2. toka, uji, ajri, klima dhe terreni;
3. asetet materiale dhe trashëgimia kulturore;
4. ndërthurjen ndërmjet faktorëve që përmenden në pikën 1,2 dhe 3.

Direktiva definon kategoritë e projekteve që janë subjekt i VNM-s, cilat procedura duhet ndjekur dhe përmbajtjen e vlerësimit.

Disa kategori të projekteve të listuara në Shtojcën I të Direktivës janë gjithmonë subjekt i VNM-s, përderisa

¹⁶ Council Directive of 27 June 1985 on the assessment of the effects of certain public and private on the environment <http://ec.europa.eu/environment/eia/home>

ato në Shtojcën II janë subjekt i VNM-s kur plotësohen kriteret e caktuar të vendosura për shtetet anëtare.

Zhvilluesi i projektit duhet të pajis autoritetin kompetent me informatat e detajizuara relevante për projektin që është subjekt i VNM-s, në mënyrë që të mundësohen komentet e autoriteteve mjedisore para se pëlqimi të jepet. Elementet e informatave që duhet në raportin mjedisor nga zhvilluesi janë dhënë në Shtojcë IV. Gjithashtu edhe publiku duhet të njoftohet me kërkesën për dhënien e pëlqimit mjedisor dhe për këtë të shpreh mendimin e vet dhe kjo është e garantuar me Direktivën 2003/35/EC e cila e harmonizon legjislacionin e BE me kërkesa e Konventës së Aarhusit. Direktiva e VNM-s ka 14 nene dhe 4 shtojca:

Shtojca I- Projektet që janë subjekt i nenit 4 (1)

Shtojca II- Projektet që janë subjekt i nenit 4(2)

Shtojca III- Kriteret e përzgjedhjes të cilave u referohet neni 4 (3)

Shtojca IV- Informacioni i cili u referohet neni 5 (1)

11.2. Direktiva 97/11/EC

Më vonë Direktiva 85/337/EEC u amendamentua nga Direktiva **97/11/EC**¹⁷, që në fakt më shumë paraqiste një modifikim i dobësive të origjinalit se sa një amendamentim, sidomos në lidhje me llojet e projekteve që duhet t'i nënshtroheshin VNM¹⁸ (në fakt numri i projekteve të Shtojcës 1 rritet nga 9 në direktivën e vjetër në 21) si dhe informatat e nevojshme për të.

¹⁷ Council Directive 97/11/EC of 3 March 1997 amending Directive 85/337/EEC

¹⁸ Në Kosovë bazuar në nenin 20 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit 2003/9, nga Qeveria e Kosovës është adoptuar Udhëzimi Administrativ për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Udhëzimi ka 36 nene dhe 3 Shtojca dhe në masë të madhe është bazuar në dispozitat e Direktivës së VNM. Gjithashtu është adoptuar edhe Udhëzimi Administrativ për Licencimin e personave dhe Ndërmarrjeve për hartimin e raporteve të VNM.

Direktiva e re vendos disa ndryshime procedurale si:

- zhvilluesi i projektit mund të kërkoj autoriteti kompetent këshilla formale lidhur me fushën e informacionit që duhet mbuluar me raportin mjedisor;
- autoriteti kompetent duhet bërë publik vendimin e tij nëse duhet ose jo VNM duke u bazuar në mendimin e përzgjedhjes;
- në raportin e VNM duhet përfshirë plani i alternativave kryesore të studiuara nga zhvilluesi dhe një indikacion për zgjedhjen e zhvilluesit.

Direktiva gjithashtu vendos kriteret e përzgjedhjes për marrjen e vendimit:

- karakteristikat e projektit (madhësia, shfrytëzimin i resurseve natyrore, ndotja dhe bezdisja);
- lokacioni i projektit (shfytëzimi i tokës, kapacitetet regjeneruese, dendësia e zonës etj.)
- karakteristikat e ndikimeve potenciale (zgjatja, frekuenca, reversibiliteti).

11.3. Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor 2001/42/EC

Qëllimi i kësaj Direktive është që të siguroj që pasojat mjedisore të planeve dhe programeve të cilat pritet të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin janë identifikuar dhe vlerësuar gjatë përgatitjes së tyre dhe para aprovimit. Publiku dhe autoritetet mjedisore mund të japin mendimin e tyre dhe të gjitha rezultatet të integrohet dhe të merren në konsideratë gjatë procedurës së planifikimit. Pas aprovimit të planit dhe programit publiku duhet të informohet me vendimin dhe mënyrën se si ai është sjellë. Në raste të ndikimeve ndërkufitare, shteti anëtar i prekur dhe publiku i tij informohen dhe kanë mundësinë e bërjes së komenteve të cilat gjithashtu integrohen në procesin e vendimmarrjes.

VSM kontribuon në planifikimin më transparent duke involvuar publikun dhe integruar konsideratat mjedisore, që është një nga synimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Direktiva ka 15 nene dhe 2 shtojca: Shtojca I- përmban informacionet e kërkuara sipas nenit 5 respektivisht në Raportin Mjedisor.

Shtojca II- që përcakton kriteret për përcaktimin e domethënies së mundshme të efekteve të parashikuara në neni 3 pika 5

Pjesmarrja e publikut në procesin e VNM

12. Konventa e Aarhusit

Konventa për Qasje në Informata, Pjesmarrjen e Publikut në Vendim-marrje dhe Qasje në drejtësi për çështje mjedisore, u adoptua me 25 qershor 1998, në qytetin danez të Aarhus në kuadër të Konferencës së IV-t "Environment for Europe". Ndërsa në fuqi Konventa ka hyrë me 30 tetor 2001¹⁹, pas nënshkrimit nga ana e 40 shteteve dhe ratifikimit nga 38 sosh.

Konventa vendos një numër të drejtash për publikun (qytetarët dhe asociacionet e tyre) lidhur me mjedisin. Autoritetet publike në nivel nacional, rajonal dhe local duhet të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Në përmbajtjen e saj rregullon 3 fusha kryesore:

1. Të drejtën e secilit që të marrë informa ta mjedisore që mbahen nga autoritetet publike ("**qasja në informacionin mjedisor**"). Kjo përfshin informacionet mbi gjendjen e mjedisit, por edhe politikat dhe masat e ndërmarra, ose gjendjen e shëndetit të njerzve dhe sigurinë kur ajo mund të ndikohet nga gjendja e mjedisit. Qytetarëve me Konvente iu garantohej që mund të marrin informacionin e kërkuar mbrenda një muaji pas kërkesës së bërë, pa qenë të obliguar t'i japin asryet se pse e kërkojnë atë informacion. Për më tepër autoritetet publike janë të obliguara me Konventë që aktivisht të shpërndajnë informacionin mjedisor që kanë në posedim (neni 4);

2. Të drejtën për të marrë pjesë që në fazat e hershme në vendimmarrje për mjedisin. Autoritete duhet t'i bëjnë të gjitha veprimet e duhura për t'ua bërë të mundshme qytetarëve dhe organizatave mjedisore për të komentuar propozimet e projekteve që mund të ndikojnë në mjedis, planet dhe programet e mjedisit, si dhe ato komente të merren në konsiderim gjatë vendimmarrjes ("**pjesmarrja e publikut në vendimmarrjen mjedisore**"-neni 6).

¹⁹ <http://www.unece.org/env/pp/ratification.htm>

3. Të drejtën që t'i drejtohen gjyqit lidhur me vendimet publike që janë marrë pa u respektuar dy të drejtat e mëparshme si dhe legjislacioni mjedisor në përgjithsi ("**qasja në drejtësi**"-neni 9).

Konventa e Aarhusit është një lloj i ri i marrëveshjes mjedisore²⁰. Ajo lidh të drejtat mjedisore dhe të drejtat e njeriut në mes vete dhe pranon se ne detyrohemi me obligime ndaj gjeneratave të ardhshme si dhe llogaridhënien qeveritare me mbrojtjen e mjedisit. Konventa thekson se zhvillimi i qëndrueshëm mund të arrihet vetëm me involvimin dhe përfshirjen e të gjithë rol-luajtësve në proces.

Konventa fokusohet në ndërveprimin ndërmjet publikut dhe autoriteteve publike në kontekst demokratik dhe është një proces i ri për pjesmarrjen e publikut në negociata dhe implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare²¹.

Subjekti i Konventës shkon thellë në marrëdhëniet në mes popujve dhe qeverive. Konventa nuk është thjesht një marrëveshje mjedisore, ajo është gjithashtu një konventë mbi llogaridhënien, transparencën dhe përgjegjësinë. Konventa i jep të drejtën publikut, dhe imponon për palët dhe autoritetet publike obligime lidhur me qasjen në informata, pjesmarrjen e publikut dhe qasjen në drejtësi për aktivitetet që i nënshtrohen VNM-s (neni 6 pika 2.e).

²⁰ “Edhe pse rajonale në fushën e saj, domethënia e Konventës së Aarhusit është globale. Ajo është elaborimi më impersionues i Parimit të 10 të Dekleratës së Rio-s, që shtron nevojën e pjesmarrjes së qytatarëve në çështjet mjedisore dhe qasjen në informatat mjedisore që mbahen nga autoritetet publike. Si e tillë ajo është ndërmarrje ambicioze në fushën e “demokracisë mjedisore” e ndërmarrë nën patronatin e OKB-s” Kofi A. Annan, Sekretar i Përgjithshëm i OKB-s

²¹ <http://www.unece.org/env/pp/documents/cep43e.pdf>

Direktiva 2003/35/EC²²

Dirrektiva ka për qëllim që të kontribuoj në implementimin e dispozitave të Konventës së Aarhusit para së gjithash në:

Sigurimin e pjesmarrjes së publikut gjatë hartimit të planeve dhe programeve që pritet të kenë ndikim në mjedis dhe

Përmirsimin e pjesmarrjes së publikut dhe sigurimin e qasjes në gjykata mbrenda direktivave 85/337/EC dhe 96/61/EC²³.

Direktiva ka 8 nene dhe 2 shtojca: Shtojca I që rregullon dispozita e nenit 2 mbi planet dhe programet ku duhet siguruar pjesmarrja e publikut; dhe

Shtojca II- e cila e shton një Shtojcë të re në Direktivën 96/61/EC.

²² Directive 2003/35/EC of the European Parliament and of the Council of 26 May 2003 providing for public participation in respect of the drawing up of certain plans and programmes relating to the environment and amending with regard to public participation and access to justice Council Directives 85/337/EEC and 96/61/EC

²³ Council Directive **96/61/EC** of 24 September 1996 concerning integrated pollution prevention and control- IPPC. OJ L 257, 10.10.1996

13. Kërkesat e legjislacionit kosovar për VNM

VNM në Kosovë si procedure është një praktikë relativisht e re. Si mjet ligjor është futur në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit²⁴ në pjesën 4, nenet 20-24.

Me këtë ligj kërkohet nga personat dhe ndërmarrjet që planifikojnë të ndërtojnë objekt industrial, të përpunimit, apo project që ka potencial të bëjë dëm mjedisor (neni 20 pika 1) dhe kur të njëjtit planifikojnë modifikimin e operimeve të objekteve industriale me rrezik potencial për të ndikuar në mjedis (neni 20 pika 2) që të bëjnë një VNM dhe të njëjtën në formë të Raportit të VNM t`ia parashtrojnë MMPH-s. Raporti i VNM sipas nenit 20 pika 6 mund të parashtrohet nga një person, ndërmarrje që kanë ekspertiza dhe që janë trajnuar në shkencat mjedisore, si dhe janë mbajtës të licencës për VNM. Për licencim Qeveria ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ për Licencimin e Personave dhe Ndërmarrjeve për hartimin e Raporteve të VNM ku parashtrohet kriteret dhe kushtet për licencim si dhe mënyra e licencimit.

Lidhur me procedurat e VNM, Qeveria ka provuar Udhëzimin Administrativ 2004/9, i cili në masë të madhe ka qenë i harmonizuar me kërkesat e Direktivave të BE në përmbajtje, procedura dhe afate kohore.

Sipas Udhëzimit Administrativ ka dy nivele të VNM:

1. VNM e plotë- që kryhet për projektet e Shtojcë I të UA; dhe
2. VNM e thjeshtë- që kryhet për projektet e Shtojcë II të UA

Kapitulli i IV i UA definon përmbajtjen e raportit të VNM. Sipas dispozitave definohej 2 lloj raportesh:

Raporti i plotë i VNM- që përgatitet për projektet e Shtojcës I dhe

²⁴ Ligji për mbrojtjen e mjedisit 2003/9 përmban 3 lloje të përlqimeve mjedisore: përlqimin mjedisor, lejen ekologjike (neni 22) dhe autorizimin mjedisor (neni 23).

Raporti i thjeshtuar i VNM-s që përgatitet për projektet e shtojcës II.

Lista e veprimtarive që i nënstrohen VNM në Kosovë

1	Prodhimi dhe procesimi i metaleve
2	Industria e mineraleve
3	Industria ekstraktuese
4	Industria kimike
5	Industria e tekstilit, lëkurës dhe letrës
6	Industria e gomës
7	Industria energjetike
8	Infrastruktura e transportit
9	Industria ushqimore
10	Trajtimi i mbeturinave dhe ujërave të shkarkuar
11	Projektet për depozitim, transport dhe furnizim të ujit
12	Industria e letrës, e drurit, e tekstilit, dhe e lëkurës
13	Turizmi
14	Bujqësia intensive, pylltari dhe peshkataria
15	Projekte të tjera

E gjithë procedura e VNM-s nga dorëzimi në MMPH e deri te dhënia ose refuzimi i pëlqimit mjedisor, sipas UA parashihet të zgjatë 60 ditë pune. Natyrisht se janë lënë të hapura mundësitë që nga aplikuesi të kërkohen informata shtesë.

Pjesmarrjen e publikut në procesin e VNM Udhëzimi Administrativ e rregullon me nenin 14, ku parashihet organizimi i konsultimeve publike për të dy llojet e raporteve, si dhe neni 15 që rregullon mbajtjen e debateve publike rreth raportit të plotë VNM para se MMPH ta jap mendimin e vet.

Duhet potencuar se në vitin 2007, janë në procedim parlamentar (kanë kaluar aprovimin në parim ose leximin e parë) dy ligje që e kompletojnë kornizën ligjore që lidhet me procesin e vlerësimit mjedisor: Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

SHTOJCA A
KONVENTA PER VLERËSIMIN E
NDIKIMIT NË MJEDIS
NË KONTEKSTIN NDËRKUFITAR
Espoo, Finlandë, 25 Shkurt 1991
HYRJE (PARATHËNIE)

Palët e kësaj Konvente,

Të ndërgjegjshëm për lidhjet ndërmjet veprimtarive ekonomike dhe pasojave të tyre mbi mjedisin,

Duke afirmuar nevojën për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe më të bazuar për mjedisin,

Të vendosur për të çuar më tej bashkëpunimin ndërkombëtar në vlerësimin e ndikimit të mjedisit, veçanërisht në kontekstin ndërkufitar,

Të kujdesur për nevojën dhe rëndësinë e zhvillimit të politikave parashikuese, largpamëse, dhe për parandalimin, zbutjen dhe monitorimin e ndikimit negativ në mjedis në përgjithësi dhe veçanërisht në kontekstin ndërkufitar,

Duke mbajtur parasysh kushtet e rëndësishme të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Deklaratës së Konferencës së Stokholmit mbi Mjedisin Human, Aktit Final të Konferencës për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë, (KSBE) dhe dokumentet përfundimtare të takimeve të Madridit e të Vienës, të përfaqësuesve të shteteve pjesëmarrëse në KSBE,

Duke lavdëruar veprimtaritë e vazhdueshme të shteteve për të siguruar që vlerësimi i ndikimit në mjedis është kryer nëpërmjet kushteve kombëtare ligjore e administrative, si dhe politikave të tyre kombëtare,

Të ndërgjegjshëm për nevojën e trajtimit të qartë të faktorëve të mjedisit në një fazë të hershme të procesit të marrjes së vendimeve, duke zbatuar vlerësimin e ndikimit të mjedisit në gjitha nivelet e duhura

administrative, si një armë e nevojshme për të përmirësuar cilësinë e informacionit të paraqitur atyre që marrin vendimet, me qëllim që të merren vendime sa më të bazuara (qëndrueshme) për mjedisin, duke i kushtuar vëmendje të veçantë minimizimit të ndikimit të rëndësishëm negativ, veçanërisht në kontekstin ndërkufitar,

Të kujdesur për përpjekjet e organizatave ndërkombëtare për të çuar më tej përdorimin e vlerësimit të ndikimit të mjedisit në nivele kombëtare e ndërko-mbëtare dhe duke marrë parasysh punën e kryer për vlerësimin e rolit të mjedi-sit nën kujdesin e Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën, në veçanti rezultatet e arritura nga seminari për vlerësimin e ndikimit të mjedisit (Shtator 1987, Varshavë, Poloni), si dhe duke vërejtur qëllimet dhe parimet për Vlerësimin e Rolit të Mjedisit, miratuar nga Këshilli Qeveritar i Programit për Mjedisin të Kombeve të Bashkuara dhe Deklaratën Ministeriale për Zhvillim të Bazuar (Maj 1990, Bergen, Norvegji)

Bien dakort si më poshtë:

Neni 1. Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Konvente

(i) **“Palë”** nënkupton, në qoftë se konteksti s’ka kuptim tjetër, Palët kontraktuese të kësaj Konvente;

(ii) **“Palë e origjinës”** nënkupton Palën Kontraktuese ose Palët e kësaj Konvente, nën juridiksionin e të cilës parashikohet të kryhet një veprimtari e propozuar;

(iii) **“Palë e prekur”** nënkupton Palën Kontraktuese ose Palët e kësaj Konvente, të mundshme për t’u prekur nga ndikimi përtej kufijve i një veprimtarie të propozuar;

(iv) **“Palë të interesuara”** nënkupton Palën e origjinës dhe Palën e prekur në vlerësimin e ndikimit të mjedisit në pajtim me këtë Konventë;

(v) “**Veprimtari e propozuar**” nënkupton çdo veprimtari ose çdo ndryshim të rëndësishëm të një veprimtarie-objekt vendimi i një autoriteti kompetent në përputhje me procedurat e zbatueshme kombëtare;

(vi) “**Vlerësimi i ndikimit të mjedisit**” nënkupton një procedurë kombëtare për të analizuar ndikimin e mundshëm mbi mjedisin të një veprimtarie të propozuar;

(vii) “**Ndikim**” nënkupton çdo pasojë mbi mjedisin të një veprimtarie të propozuar, duke përfshirë shëndetin, e njerëzve, sigurimin e tyre, florën, faunën, tokën, ajrin, ujin, klimën, peisazhin dhe monumentet historike ose struktura të tjera fizike apo ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve; gjithashtu përfshin pasojat mbi trashëgiminë kulturore ose kushtet ekonomiko-shoqërore që janë rezultat i ndryshimeve të këtyre faktorëve;

(viii) “**Ndikim ndërkufitar**” nënkupton çdo ndikim, jo vetëm të një natyre globale, brenda zonës në juridiksionin e një Pale, të shkaktuar nga një veprimtari e propozuar, origjina fizike e të cilës ndodhet plotësisht ose pjesërisht brenda fushës së juridiksionit të një Pale tjetër;

(ix) “**Autoriteti kompetent**” nënkupton autoritetin kombëtar ose autoritetet e përcaktuara nga një Palë përgjegjëse për zbatimin e detyrave të mbuluara nga kjo Konventë dhe/ose autoritetin apo autoritetet, të cilave një Palë u jep fuqi për marrjen e vendimeve në lidhje me një veprimtari të propozuar;

(x) “**Publik**” nënkupton një a më shumë persona fizikë ose juridikë.

Neni 2. Kushtet e përgjithshme

1. Palët ose individualisht, ose së bashku, do të marrin të gjithë masat e duhura dhe efektive për të parandaluar, reduktuar e kontrolluar ndikimin e rëndësishëm negativ mbi mjedisin ndërkufitar nga veprimtaritë e propozuara.

2. Secila Palë do të marrë masat e nevojshme ligjore administrative etj., për zbatimin e kushteve të kësaj Konvente, duke përfshirë për sa i përket veprimtarive të propozuara në listën e shtojcës i, të mundshme për të shkaktuar ndikim të rëndësishëm negativ ndërkuftar, vendosjen e një procedure për vlerësimin e ndikimit të mjedisit, që lejon pjesëmarrjen e publikut dhe përgatitjen e dokumentacionit për vlerësimin e ndikimit të mjedisit të përshkruar në shtojcën II.

3. Pala e origjinës do të sigurojë që, në përputhje me kushtet e kësaj Konvente, vlerësimi i ndikimit të mjedisit të ndërmerret para një vendimi për të autorizuar ose ndërmarrë një veprimtari të propozuar të rreshtuar në shtojcën i, që ka të ngjarë të shkaktojë një ndikim negativ të rëndësishëm ndërkuftar.

4. Pala e origjinës do të sigurojë, në përputhje me kushtet e kësaj Konvente, që Palët e prekura të njoftohen për një veprimtari të propozuar (shtojca i), që është e mundshme të shkaktojë një ndikim negativ të rëndësishëm ndërkuftar.

5. Palët e interesuara do të hyjnë në diskutim nëse një apo disa veprimtari të propozuara që nuk janë në shtojcën i, është ose janë të mundshme të shkaktojnë një ndikim negativ të rëndësishëm përtej kufijve dhe duhet të trajtohen sikur ajo ose ato, të ishin në listën e shtojcës i. Kur këto Palë bien dakort, veprimtaria ose veprimtaritë do të trajtohen si të tilla.

Drejtimi i përgjithshëm për kritere identifikimi në përcaktimin e ndikimit negativ të rëndësishëm jepet në Shtojcën 3.

6. Pala e origjinës, në përputhje me kushtet e kësaj Konvente, do të sigurojë mundësi për publikun, në fushat e mundshme për t'u prekur, për të marrë pjesë në procedurat përkatëse të vlerësimit të ndikimit të mjedisit në lidhje me veprimtaritë e propozuara dhe do të sigurojë që mundësia e publikut të Palës së prekur të jetë e njëjtë me atë që i sigurohet Palës së origjinës.

7. Vlerësimet e Ndikimit të Mjedisit, siç kërkohet nga Konventa si kërkesë minimale, do të ndërmerren në nivel projekti të veprimtarisë së propozuar. Në

gjerësinë e duhur, Palët do të përpiqen të zbatojnë parimet e vlerësimit të ndikimit të mjedisit në politikat, planet dhe programet.

8. Kushtet e kësaj Konvente nuk do të prekin të drejtën e Palëve për të zbatuar ligjet kombëtare, rregullat, kushtet administrative ose praktikat e pranuar ligjore në mbrojtje të informacionit, dhënia e të cilit është e dëmshme për sekretin industrial e tregtar ose për sigurimin kombëtar.

9. Kushtet e kësaj Konvente nuk do të prekin të drejtën e Palëve të veçanta për të zbatuar me marrëveshje dyPalëshe e shumëPalëshe kur duhet, masa më rigorozë se ato të Konventës së tanishme.

10. Kushtet e kësaj Konvente nuk do të dëmtojnë detyrimet e Palëve nga ligji ndërkombëtar, për sa i përket veprimtarive që kanë ose mund të kenë ndikim ndërkufitar.

Neni 3. Njoftimi

1. Për një veprimtari të propozuar në listën e shtojcës i, që është e mundshme të shkaktojë një ndikim negativ të rëndësishëm përtej kufijve, pala e origjinës, për hir të sigurimit të konsultimeve të mjaftueshme dhe efektive në nenin 5, do të njoftojë çdo Palë, që ajo konsideron që mund të jetë Palë e prekur sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se sa njoftimi i publikut të saj për këtë veprimtari të propozuar.

2. Ky njoftim do të përmbajë ndër të tjera:

- a. Informacion mbi veprimtarinë e propozuar, duke përfshirë çdo të dhënë të disponueshme për ndikimin ndërkufitar;
- b. Natyra e vendimit të mundshëm dhe
- c. Një tregues të kohës së arsyeshme, brenda së cilës kërkohet përgjigje, duke marrë parasysh natyrën e veprimtarisë së propozuar (në paragrafin 3 të këtij neni) dhe mund të përfshijë informacion të dhënë në paragrafin 5 të këtij neni.

3. Pala e prekur do t'i përgjigjet Palës së origjinës brenda kohës së specifikuar në njoftim, duke pranuar marrjen e njoftimit, dhe do të tregojë nëse ka ndërmend të marrë pjesë në procedurën e Vlerësimit të ndikimit mbi Mjedisin.

4. Në qoftë se Pala e prekur tregon që s'ka ndër mend të marrë pjesë në procedurën e vlerësimit të ndikimit të mjedisit, ose nuk përgjigjet brenda kohës së specifikuar në njoftim, kushtet në paragrafet 5, 6, 7 e 8 të këtij neni dhe në nenet 4 deri 7 nuk do të zbatohen. Në rast rrethanash të tilla e drejta e Palës së origjinës për të përcaktuar nëse do të zbatojë vlerësimin e ndikimit të mjedisit në bazë të ligjit të saj kombëtar dhe praktikës nuk dëmtohet.

5. Me marrjen e një përgjigje nga pala e prekur, që tregon dëshirën e saj të marrë pjesë në procedurën e Vlerësimit të Ndikimit të Mjedisit, pala e origjinës, në rast se nuk e ka bërë kështu, do t'i sigurojë Palës së prekur:

- a. informacion të rëndësishëm në lidhje me procedurën e Vlerësimit të Ndikimit të Mjedisit, duke përfshirë një tregues të kohës për transmetimin e komenteve;
- b. informacion të rëndësishëm për veprimtarinë e propozuar dhe ndikimin e rëndësishëm negativ përtej kufirit.

6. Një Palë e prekur, me kërkesë të Palës së origjinës do t'i sigurojë së dytës informacion të grumbullueshëm në mënyrë të arsyeshme në lidhje me mjedisin potencialisht të prekur nën juridiksionin e Palës së prekur, kur një informacion i tillë është i nevojshëm për përgatitjen e dokumentacionit për vlerësimin e ndikimit të mjedisit. Informacioni do të jepet menjëherë dhe si duhet, nëpërmjet një grupi të bashkuar, aty ku ai ekziston.

7. Kur një Palë mendon që do mund të preket nga një ndikim negativ i rëndësishëm ndërkufitar prej një veprimtarie të propozuar në shtojcën i dhe kur asnjë njoftim nuk është bërë në lidhje me paragrafin 1 të këtij neni, Palët e interesuara, me kërkesë të Palës së prekur,

do të shkëmbejnë informacion të mjaftueshëm për të zhvilluar diskutime, nëse është e mundshme të ketë ndikime negative të rëndësishme ndërkufitare. Në qoftë se Palët bien dakort, që mund të ketë ndikim negativ të rëndësishëm ndërkufitar, do të zbatohen kushtet e kësaj Konvente.

Në qoftë se Palët nuk bien dakort, secila Palë mund t'ia paraqesë këtë çështje një komisioni (hetimor), në përputhje me kushtet e shtojcës IV për t'u këshilluar mbi mundësinë e një ndikimi negativ të rëndësishëm ndërkufitar, në rast se s'bien dakort për ndonjë metodë tjetër të sqarimit të kësaj çështjeje.

8. Palët e interesuara duhet të sigurojnë që publiku i Palës së prekur në zonat e mundshme për t'u prekur, të jetë i informuar dhe t'i jepen mundësitë për të bërë komente e kundërshtuar veprimtaritë e propozuara dhe për të transmetuar këto komente ose kundërshtime tek autoriteti kompetent i Palës së origjinës, ose drejtpërdrejt këtij autoriteti ose nëpërmjet Palës së origjinës.

Neni 4. Përgatitja e dokumentacionit për vlerësimin e ndikimit të mjedisit

1. Ky dokumentacion që i paraqitet autoritetit kompetent të Palës së origjinës do të përmbajë si minimum, informacionin e përshkruar në shtojcën II.

2. Pala e origjinës do t'i japë Palës së prekur nëpërmjet një grupi të bashkuar ku ai ekziston dokumentacion për vlerësimin e ndikimit të mjedisit. Palët e interesuara do të rregullojnë shpërndarjen e dokumentacionit tek autoritetet dhe publiku i Palës së prekur në zonat e mundshme për t'u prekur dhe për paraqitjen e komenteve ndaj autoritetit kompetent të Palës së origjinës, ose drejtpërdrejt kur duhet nëpërmjet Palës së origjinës, brenda një kohe të mjaftueshme para se të merret vendimi përfundimtar për veprimtarinë e propozuar.

Neni 5. Konsultat në bazë të dokumentacionit për vlerësimin e ndikimit të mjedisit

Pala e origjinës, pas përfundimit të dokumentacionit për vlerësimin e ndikimit të mjedisit, pa hezitim do të hyjë në konsulta me Palën e prekur, duke përfshirë ndër të tjera ndikimin potencial ndërkufitar të veprimtarisë së propozuar dhe masat për të reduktuar ose mënjeluar këtë ndikim. Konsultat lidhen me:

- a. Alternativa të mundshme për veprimtarinë e propozuar, që përfshijnë alternativën jovepruese dhe masat e mundshme për të lehtësuar ndikimin negativ të rëndësishëm përtej kufijve dhe për të monitoruar efektet e këtyre masave në kurriz të Palës së origjinës;
- b. Forma të tjera të ndihmës së mundshme të dyanshme me reduktimin e ndikimit negativ të rëndësishëm përtej kufijve të veprimtarisë së propozuar; dhe
- c. Çdo çështje tjetër të lidhur me veprimtarinë e propozuar.

Palët do të bien dakort, në fillim të konsultave të këtitilla, për kohën e arsyeshme për zgjatjen e periudhës së konsultave. Secila nga këto konsulta do të drejtohet nga një grup i përbashkët, kur ai ekziston.

Neni 6. Vendimi përfundimtar

1. Palët do të sigurojnë që në vendimin përfundimtar për veprimtarinë e propozuar vëmendje e duhur t'i kushtohet rezultatit të dokumentacionit për vlerësimin e ndikimit të mjedisit, si dhe komenteve të marra në përputhje me nenet 3, paragrafit 8, nenit 4, paragrafit 2 si dhe rezultatit të konsultave, siç thuhet në nenin 5.
2. Pala e origjinës do t'i sigurojë Palës së prekur vendimin përfundimtar për veprimtarinë e propozuar, krahas arsyeve dhe konsideracioneve në të cilat ai është bazuar.
3. Në qoftë se informacioni shtesë për ndikimin e rëndësishëm përtej kufijve të një veprimtarie të

propozuar, i cili nuk qe në dispozicion në kohën e marrjes së vendimit përse i përket kësaj veprimtarie dhe i cili mund të kish prekur materialisht vendimin, vihet në dispozicion të një pale të interesuar para se të filloj puna për këtë veprimtari, atëhere kjo Palë menjëherë do të informojë Palën ose Palët e tjera të interesuara. Në qoftë se një nga Palët e interesuara kërkon një gjë të tillë, konsultat do të mbahen nëse vendimi ka nevojë të ndryshohet.

Neni 7. Analizat e pas projektit

1. Palët e interesuara, me kërkesë të secilës Palë, do të përcaktojnë nëse, dhe në qoftë se kështu në çfarë mase, do të bëhet një analizë pas projektit, duke marrë parasysh ndikimin e mundshëm negativ të rëndësishëm përtej kufijve të veprimtarisë, për të cilën një vlerësim i ndikimit të mjedisit është ndërmarrë në pajtim me këtë Konventë. Çdo analizë e pas projektit e ndërmarrë do të përfshijë veçanërisht mbikqyrjen e veprimtarisë dhe përcaktimin e çdo ndikimi negativ përtej kufijve. Mbikqyrja dhe përcaktimi i tillë do të ndërmerren me qëllim që të arrihen objektivat e listës në shtojcën V.

2. Kur si rezultat i analizës së pas projektit, pala e origjinës ose pala e prekur ka arsye të mjaftueshme për të konkluduar që ka ndikim të rëndësishëm negativ përtej kufijve, ose zbulohen faktorë që mund të rezultojnë në një ndikim të tillë, atëherë ajo menjëherë duhet të informojë Palën tjetër. Palët e interesuara më tej do të konsultohen për masat e nevojshme në reduktimin ose mënjanimin e ndikimit.

Neni 8. Bashkëpunimi dyPalësh e shumëPalësh

Palët mund të vazhdojnë të ekzistojnë ose hyjnë në marrëdhënie të reja dy ose shumëPalëshe apo organizimi të tjera paraprake, me qëllim që të zbatojnë detyrimet e tyre në këtë Konventë. Të tilla marrëveshje ose organizime mund të bazohen në elementet e listës së shtojcës VI.

Neni 9. Programet kërkimore

Palët do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë ngritjes ose intensifikimit të programeve specifike kërkimore, me qëllim që:

- a. të përmirësohen metodat cilësore e sasiore për vlerësimin e ndikimeve të veprimtarive të propozuara;
- b. të arrihet një kuptim më i mirë i lidhjeve shkak-pasojë dhe roli i tyre në administrimin e integruar të mjedisit;
- c. të analizojë e monitorojë zbatimin efikas të vendimeve për veprimtaritë e propozuara, me qëllim që të minimizohen ose parandalohen ndikimet;
- d. të zhvillojë metoda që nxitin studime kryesore në kërkim të alternativave të qëndrueshme në drejtim të ruajtjes së mjedisit për veprimtaritë e propozuara, prodhimin e konsumin;
- e. të zhvillojë metodologji për zbatimin e parimeve të vlerësimit të ndikimit të mjedisit në nivel makroekonomik.

Rezultatet e programeve të dhëna më sipër duhet të shkëmbehen nga Palët.

Neni 10. Statuti i shtojcave

Shtojcat që i bashkëngjiten kësaj Konvente janë pjesë integrale e saj.

Neni 11. Takimi i Palëve

1. Palët do të takohen si të jetë e mundur, në lidhje me sesionet vjetore të këshilltarëve të qeverive të KEE për problemet e mjedisit dhe të ujit. Takimi i parë do të bëhet jo më vonë se 1 vit pas datës që hyn në fuqi kjo Konventë. Më tej takimet e Palëve do të bëhen në çdo kohë tjetër që do të gjykohet e nevojshme nga një takim i Palëve ose me kërkesë me shkrim të njëjës Palë, me kusht që brenda 6 muajve të komunikimit të kërkesës

nga Sekretariati, kjo kërkesë të mbështetet nga të paktën 1/3 e Palëve.

2. Palët do të kenë vazhdimisht parasysht zbatimin e Konventës dhe me këtë qëllim në mendje do të:

- a. rishikojnë politikat dhe kundërshtimet metodologjike ndaj vlerësimit të ndikimit të mjedisit nga Palët, me qëllim që të përmirësojnë më tej procedurat e vlerësimit të ndikimit të mjedisit në kuadër ndërkufitar;
- b. shkëmbejnë informacion në lidhje me përvojën e fituar në përfundimin e zbatimit e marrëveshjeve dy a më shumëpalëshe ose të organizmave të tjerë në lidhje me përdorimin e vlerësimit të ndikimit të mjedisit në kuadër ndërkufitar, ku bëjnë pjesë një a më shumë Palë.
- c. kërkojnë, aty ku duhet, shkëmbimet e grupeve kompetente ndërkombëtare dhe komiteteve shkencore në aspektet teknike e metodologjike, që i përkasin arritjes së qëllimeve të kësaj Konvente.
- d. Në takimin e tyre të parë marrin parasysht dhe me konsensus miratojnë rregullat proceduriale për takimet e tyre.
- e. Marrin parasysht dhe, kur është e nevojshme, adaptojnë propozime për amendamente ndaj kësaj Konvente.
- f. Marrin parasysht dhe ndërmarrin veprime shtesë që mund të kërkohen për arritjen e qëllimeve të kësaj Konvente.

Neni 12. E drejta për të votuar

1. Secila Palë e kësaj Konvente do të ketë 1 votë.

2. Përveç asaj që thuhet në paragrafin 1 të këtij neni, organizatat rajonale të integritit ekonomik, në çështje e brenda kompetencave të tyre, do të ushtrojnë të drejtën për të votuar me numër të barabartë votash me numrin e shteteve anëtare, që janë Palë në këtë

Konventë. Organizata të tilla nuk do të ushtrojnë të drejtën për të votuar, nëse shtetet e tyre anëtare ushtrojnë të drejtën e tyre dhe anasjelltas.

Neni 13. Sekretariati

Sekretariati Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Evropën do të ketë funksionet e mëposhtme sekretariale:

- a. mbledhjen dhe përgatitjen e takimeve të Palëve;
- b. transmetimin e raporteve e informacionit tjetër të marrë në përputhje me kushtet e kësaj Konvente të Palët, dhe
- c. zbatimin e funksioneve të tjera që mund t'i jepen në këtë Konventë ose që mund të përcaktohen nga Palët.

Neni 14. Amendamentet e Konventës

1. Çdo Palë mund të propozojë amendamente për Konventën.
2. Amendamentet e propozuara do t'i paraqiten me shkrim sekretariatit, i cili ia komunikon ato të gjitha Palëve. Amendamentet e propozuara do të diskutohen në takimin tjetër të Palëve me kushte që Sekretariati t'i ketë shpërndarë ato të paktën 90 ditë përpara.
3. Palët do të bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshje (me konsensus) për çdo amendament të propozuar. Në qoftë se gjithë përpjekjet për konsensus nuk kanë sukses dhe marrëveshja nuk arrihet, amendamenti, si mundësi e fundit, do të miratohet me votat e një shumice prej 3/4 e Palëve të pranishme dhe votuese në takim.
4. Amendamentet e kësaj Konvente, të pranuar sipas paragrafit 3 të këtij neni, do të paraqiten Palëve për ratifikim, miratim ose pranim nga Depozituesi. Ato hyjnë në fuqi për Palët që i kanë ratifikuar, miratuar ose pranuar ditën e 90të pas marrjes nga depozituesi të njoftimit të ratifikimit, aprovimit apo pranimi nga të

paktën 3/4 e këtyre Palëve. Më pas ato do të hyjnë në fuqi për çdo Palë tjetër në ditën e 90, pasi kjo Palë depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, miratimit a pranimin të amendamentit.

5. Për qëllim të këtij neni “Palët e pranishme dhe që votojnë” nënkupton Palët që janë të pranishme dhe japin një votë pozitive ose negative.

6. Procedura e votave e dhënë në paragrafin 3 të këtij neni, nuk ka qëllim të përbëjë një precedent për marrëveshjet e ardhshme brenda Komisionit Ekonomik për Evropën.

Neni 15. Zgjidhja e debateve

1. Në qoftë se lind një mosmarrëveshje mes dy a më shumë Palëve rreth interpretimit ose zbatimit të kësaj Konvente, ato do të kërkojnë një zgjidhje nëpërmjet bisedimeve ose me anë të çdo metode tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pranuar nga Palët në këtë mosmarrëveshje.

2. Kur firmosin, ratifikojnë, pranojnë, miratojnë ose aderojnë në këtë Konventë, ose në çdo kohë më pas, një Palë mund të deklarojë me shkrim te depozituesi që për një mosmarrëveshje të pazgjidhur në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, pranon njërën ose të dyja mjetet e mëposhtme të zgjidhjes së debatit, si të detyrueshme në lidhje me çdo Palë që pranon të njëjtën detyrim.

- a. Paraqitjen e mosmarrëveshjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë
- b. Arbitrazhi në përputhje me procedurat e paraqitura në shtojcën VII.

3. Në qoftë se Palët debatuese kanë pranuar të dyja mjetet e zgjidhjes së mosmarrëveshjes të referuara në paragrafin 2 të këtij neni, mosmarrëveshja mund t'i paraqitet vetëm Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në qoftë se Palët nuk bien dakort ndryshe.

Neni 16. Firmosja

Kjo Konventë do të hapet për firmosje në Espoo (Finlandë) nga 25 Shkurt – 1 Mars 1991 dhe pas kësaj në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork deri më 2 Shtator 1991 nga shtetet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, si dhe shtetet që kanë statusin e konsultuesit (vëzhguesit) në Komisionin Ekonomik për Europën, në pajtim me paragrafin 8 të rezolutës 36 (IV) të datës 28 Mars 1947 të Këshillit Ekonomik e Social dhe nga organizatat rajonale të integritit ekonomik të përbëra nga shtete sovraane anetare të Komisionit Ekonomik për Europën, të cilave shtetet e tyre anëtare u kanë transferuar kompetencën për sa i përket çështjeve që rregullohen nga kjo Konventë, duke përfshirë kompetencën për të hyrë në traktate për sa i përket këtyre çështjeve.

Neni 17. Ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Kjo Konventë do të jetë objekt ratifikimi, pranimi ose miratimi nga shtetet pjesëmarrëse dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik.
2. Kjo Konventë do të jetë e hapur për aderim nga 3 shtatori 1991 për shtetet dhe organizatat e referuara në nenin 16.
3. Instrumentat e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit duhet të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do të ushtrojë funksionet e Depozitës.
4. Çdo organizatë e përmendur në nenin 16 e cila bëhet Palë e Konventës ndërkohe që asnjë nga shtetet anëtare të saj nuk janë Palë duhet të marrë përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo Konventë. Në rastet e organizatave të tilla kur një ose disa shtete anëtare të saj janë Palë e Konventës, organizata dhe shtetet anetare të saj duhet të vendosin në përputhje me përgjegjësitë respektive të tyre në lidhje me ekzekutimin e detyrimeve të rrjedhura nga kjo Konventë. Në raste të tilla, organizata dhe shtetet anëtare nuk mund të ushtrojnë paralelisht të drejtat e rrjedhura nga kjo Konventë.

5. Organizatat rajonale të integritit ekonomik të përmendura në nenin 16 duhet të deklarojnë në instrumentat e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, shtrirjen e kompetencave të tyre në lidhje me çështjet e trajtuara nga kjo Konventë. Gjithashtu këto organizata duhet të informojnë Depozitën për çdo modifikim përkatës të kompetencave të tyre.

Neni 18. Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e 90 pas depozitimit të instrumentit të 16 të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.
2. Për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik nuk do të numërohet si shtesë të instrumentave të depozituara nga shtetet anëtare të kësaj organizate.
3. Për çdo shtet ose organizatë të përmendur në nenin 16 i cili ratifikon, pranon, ose miraton këtë Konventë apo aderon në të pas depozitimit të instrumentit të 16 të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e 90 pas datës së depozitimit nga ky shtet ose organizatë e instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 19. Dorëheqja

Në çdo kohë pas 4 vjetësh nga data në të cilën Konventa hyn në fuqi, një Palë mund të japë dorëheqjen nga Konventa, duke i dhënë një njoftim me shkrim depozituesit. Çdo tërheqje e tillë hyn në veprim ditën e 90 pas datës së marrjes së njoftimit nga depozituesi. Çdo dorëheqje nuk prek zbatimin e neneve 3 deri 6 të Konventës për një veprimtari të propozuar, për sa i përket së cilës një njoftim është bërë në përputhje me Nenin 3 paragrafi 1, ose një kërkesë është bërë në përputhje me Nenin 3, paragrafi 7 përpara se sa një tërheqje të hyjë në fuqi.

Neni 20. Tekstet autentike

Originali i kësaj Konvente, tekstet anglisht, frëngjisht dhe rusisht të të cilit janë njësoj autentike, do të depozitohet tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Sipas dëshmisë autorizuese të nënshkruesve, kjo Konventë u nënshkrua prej tyre.

U përfundua në Espoo (Finlandë), në ditën e 25-të të Shkurtit më 1991.

SHTOJCA I

LISTA E AKTIVITETEVE

1. Rafineri të naftës bruto (duke përjashtuar sipërmarrje për prodhimin vetëm të lubrifikantëve prej naftës bruto) dhe instalime për gazifikimin dhe lëngëzimin e 500 toneve ose më tepër të qymyrgurit ose rërës bituminoze, në ditë.
2. Termocentrale dhe instalime të tjera djegie me një prodhim ngrohjeje prej 300 MW ose më tepër dhe stacione energjie bërthamore dhe reaktorë të tjerë bërthamorë (me përjashtim të instalimeve të vendosura për studimin e prodhimit dhe shndërrimit të materialeve të zbërthyeshme dhe pjellore fuqia maksimale e të cilave nuk kalon 1 kilovat ngarkesë termale të vazhdueshme).
3. Instalime të projektuara vetëm për prodhimin ose pasurimin e lëndëve djegëse bërthamore, për ripërpunimin e lëndëve djegëse bërthamore ndriçuese, ose për depozitimin, asgjësimin dhe përpunimin e mbeturinave radioaktive.
4. Instalime kryesore për shkrirjen fillestare të hekurit dhe çelikut dhe për prodhimin e metaleve jo të zeza.
5. Instalime për nxjerrjen e asbestit dhe për përpunimin e transformimin e asbestit dhe produkteve që përmbajnë asbest: për produkte asbesti-çimentoje me

një prodhim vjetor mbi 20,000 ton produkte përfundimtare; për materiale fërkimi me një prodhim vjetor mbi 50 ton produkte përfundimtare; dhe për përdorime të tjera të asbestos prej mbi 200 ton në vit.

6. Instalime kimike të integruara.

7. Ndërtimi i autostradave, rrugëve ekspres, dhe linjave të distancave të gjata të hekurudhave dhe aeroporteve me një gjatësi mesatare prej 2,100 metra ose më tepër.

8. Tubacione me diametër të madh për naftë dhe gaz.

9. Porte tregtare dhe rrugë ujore të brendshme si dhe porte për trafik ujqor të brendshëm që lejon kalimin e anijeve mbi 1,350 ton.

10. Instalime për asgjësimin e mbeturinave nëpërmjet djegies, trajtimit kimik ose për zonat e grumbullimit të mbeturinave toksike dhe atyre të rrezikshme.

11. Diga dhe rezervuar të mëdhenj.

12. Aktivitete për nxjerrjen e ujqit nëntokësor në rastet kur volumi vjetor i ujqit të nxjerrë arrin në 10 milion metra kub ose më tepër.

13. Prodhimi i letrës ose brumit të letrës prej 200 tonëve metrik të tharë ose më tepër.

14. Aktivitete minerare kryesore, nxjerrje dhe përpunim të metaleve xeheror ose qymyrgurit.

15. Prodhimi i hidrokarbureve në breg të detit.

16. Hapësira kryesore depozitimi për naftë, petrokimikate, dhe produkte kimike.

17. Shpyllëzimi i zonave të mëdha.

SHTOJCA II

**PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT TË
VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

Informacioni i përfshirë në dokumentacionin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me nenin 4 duhet të përmbajë si minimum:

- a. Një përshkrim të aktivitetit të propozuar dhe qëllimin e tij;
- b. Kur është e përshtatshme, një përshkrim të alternativave të arsyeshme (për shembull, vendndodhjeje ose teknologjike) të aktivitetit të propozuar si dhe gjithashtu të alternativës së mos veprimit.
- c. Një përshkrim të mjedisit të mundshëm për t'u prekur në mënyrë serioze nga veprimtaria e propozuar e alternativat e saj;
- d. Një përshkrim të ndikimit potencial të mjedisit nga veprimtaria e propozuar e alternativat e saj, si dhe një vlerësim të rëndësisë së tij;
- e. Një përshkrim të masave lehtësuese për të mbajtur në minimum ndikimin negativ të mjedisit;
- f. Një tregues të qartë të metodave parashikuese, supozimeve të theksuara, si dhe të dhënave përkatëse të rëndësishme për mjedisin që janë përdorur;
- g. Identifikim të mungesave në njohuri dhe pasiguri të ndeshura në përpilimin e informacionit të kërkuar;
- h. Kur duhet, një skelet të programeve të monitorimit e drejtimit e të planeve për analizë pas projekti dhe
- i. Një përmbledhje joteknike që përfshin prezantimin vizual si harta, grafikë, etj.

SHTOJCA III
KRITERE TË PËRGJITHSHME PËR TË
NDIHMUAR NË PËRCAKTIMIN E
RËNDËSISË PËR MJEDISIN TË
VEPRIMTARIVE TË PARRADHITURA NË
SHTOJCËN I

1. Duke trajtuar veprimtaritë e propozuara për të cilat aplikohet neni 25, Palët e interesuara mund të trajtojnë nëse veprimtaria ka të ngjarë të ketë një ndikim negativ të rëndësishëm ndërkufitar, veçanërisht nëpërmjet një a më shumë nga kriteret e mëposhtme.

- a. Madhësia: Veprimtaritë e propozuara që janë të mëdha për tipin e veprimtarisë;
- b. Vendosja: Veprimtaritë e propozuara që janë vendosur në ose pranë një zone me rëndësi ose sensitivitet special ambjental (si toka nën ujë të përcaktuara në Konventën e Ramsarit, parqe kombëtare, rezervate natyrore, vende interesi shkencor të veçantë ose vende me rëndësi historike, kulturore ose arkeologjike); gjithashtu veprimtari të propozuara në vende ku karakteristikat e zhvillimit të propozuar ka të ngjarë të kenë pasoja të ndjeshme mbi popullsinë.
- c. Pasojat: Veprimtaritë e propozuara me pasoja veçanërisht komplekse e potencialisht negative, duke përfshirë ato që japin efekte serioze të njerëzimit ose në organizma dhe specie me vlerë, ato që kërcënojnë përdorimin ekzistues apo potencial të një zone të prekur, dhe ato që shkaktojnë ngarkesë shtesë që nuk mund të mbahet nga kapaciteti i mjedisit.

2. Palët e interesuara do të marrin parasysh për këtë qëllim veprimtari të propozuara, të cilat mund të shkaktojnë efekte të rëndësishme ndërkufitare shumë të zhvendosura nga vendi i zhvillimit.

SHTOJCA IV

PROCEDURA HETIMORE

1. Pala ose Palët kërkuese (pretenduese) do të njoftojnë sekretariatit, që ajo ose ato ia paraqesin çështjen nëse një veprimtari e propozuar e përfshirë në listën e shtojcës 1, mund të ketë një ndikim negativ të rëndësishëm ndërkufitar, një komision hetimor të vendosur në perputhje me kushtet e kësaj shtojce. Ky njoftim do të ketë përmbajtjen e hetimit. Sekretariati do të njoftojë menjëherë gjithë Palët Konventës për këtë dokument të dorëzuar.

2. Komisioni hetimor do të ketë 3 anëtarë. Edhe pala kërkuese edhe pala tjetër në procedurën hetimore do të caktojnë një ekspert shkencor ose teknik dhe të dy ekspertët me marrëveshje të përbashkët do të caktojnë ekspertin e tretë, që do të jetë president i komisionit hetimor. Ky i fundit nuk duhet të jetë vendas në një nga Palët që marrin pjesë në procedurën hetimore, as të banojë në territorin e njërës nga këto Palë, as të jetë punësuar nga ndonjëra prej tyre e as të jetë marrë me çështjen.

3. Në qoftë se presidenti i komisionit hetimor nuk është caktuar brenda dy muajve nga caktimi i ekspertit të dytë, atëherë sekretari ekzekutiv i KEE me kërkesë të cilësdo prej Palëve, do të caktojë presidentin brenda një periudhe tjetër dy mujore.

4. Nëse njera nga Palët e procedurës hetimore nuk cakton një ekspert brenda 1 muaji nga marrja e njoftimit nga sekretariati, pala tjetër mund të informojë presidentin e komisionit hetimor i cili do të caktojë presidentin e komisionit brenda dy muajve më pas. Me caktimin e presidentit, ky do t'i kalojë Palës që ka caktuar ekspertin ta caktojë atë brenda 1 muaji. Pas një periudhe të tillë presidenti do të informojë sekretariatit ekzekutiv të KEE, i cili do të bëjë caktimin brenda një periudhe prej dy muajsh më pas.

5. Komisioni hetimor do të adoptojë rregullat e tij procedurale.

6. Komisioni hetimor do të marrë të gjithë masat e duhura me qëllim që të zbatojë funksionet e tij.
7. Palët në procedurën hetimore do të lehtësojnë punën e komisionit hetimor dhe veçanërisht duke përdorur gjithë mjetet në dispozicion të tyre:
 - a. do të sigurojë të gjitha dokumentet e rëndësishme përkatëse, e lehtësitë e informacionit.
 - b. do të bëjë të mundur, kur është e nevojshme, të thërrasë dëshmitarë ose ekspertë e të marrë dëshmitë e tyre.
8. Palët dhe ekspertët do të mbrojnë sekretin e çdo informacioni që marrin në konfidencë gjatë punës së komisionit hetimor.
9. Nëse njëra nga Palët në procedurën hetimore nuk paraqitet para komisionit hetimor ose nuk paraqet rastin e saj, pala tjetër mund t'i kërkojë komisionit hetimor të vazhdojë procedurën dhe përfundojë punën e tij. Mungesa e një pale ose mungesa e një pale që të paraqesë rastin e saj nuk përbën pengesë për vazhdimin e përfundimin e punës të komisionit hetimor.
10. Në rast se komisioni hetimor nuk përcakton ndryshime për hir të rrethanave të veçanta të çështjes shpenzimet e komisionit hetimor do të shpërndahen në pjesë të barabarta nga Palët në procedurën hetimore. Komisioni hetimor do të mbajë shënim gjithë shpenzimet e tij dhe më tej do t'u çojë Palëve deklaratën përfundimtare.
11. Çdo Palë që ka interes faktik në çështjen e komisionit hetimor dhe që mund të preket nga një opinion për (mbi) çështjen, mund të ndërhyjë në procedurë me lejen e komisionit hetimor.
12. Vendimet e komisionit hetimor për çështjet e procedurës do të merren me shumicë votash të anëtarëve. Mendimi final i komisionit hetimor do të pasqyrojë pikpamjen e shumicës së anëtarëve dhe do të përfshijë çdo pikëpamje të kundërt.
13. Komisioni hetimor do të paraqesë mendimin për përfundimtar brenda dy muajve nga dita që u morë, në

qoftë se nuk e gjen të nevojshme t'a zgjatë këtë limit kohe për një periudhë që nuk i kalon të dy muajt.

14. Mendimi përfundimtar i komisionit hetimor do të bazohet në parime shkencore të pranuar. Ai do t'i transmetohet Palëve në procedurën hetimore dhe sekretariatit.

SHTOJCA VI

ELEMENTET PËR BASHKËPUNIM DY E SHUMËPALËSH

1. Palët e interesuar mund të ngrenë kur duhet organizime institucionale ose zmadhojnë mandatin e organizimeve institucionale ekzistuese brenda kuadrit të marrëveshjeve dy apo shumë Palëshe, me qëllim që t'i japin efekt të plotë Konventës.

2. Marrëveshjet dy e shumë Palëshe ose organizimet e tjera mund të përfshijnë:

- a. Çdo kërkesë shtesë për zbatimin e kësaj Kovente, duke marrë parasysh kushtet specifike të nën rajonit në interes;
- b. Organizimat institucionale, administrative e tjera bëhen në baza ekuivalente e reciproke.
- c. Harmonizimi i politikave të tyre dhe masave për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim që të arrihet ngjashmëri e madhe e mundshme me standartet e metodat e lidhura me zbatimin e vlerësimit të Ndikimit të Mjedisit.
- d. Zhvillimin dhe/ose përmirësimin e metodave dhe programeve për identifikimin, masën, parashikimin dhe vlerësimin e ndikimeve, si dhe për analizën e pasprojektit.
- e. Zhvillimi dhe/ose përmirësimi i metodave dhe programeve për mbledhjen, analizën, ruajtjen e shpërndarjen në kohë të të dhënave të krahasueshme në lidhje me cilësinë e mjedisit.

Me t'u caktuar, presidenti i trupit gjykues do t'i kërkojë Palës që nuk e ka caktuar gjykatësin, që t'a bëjë këtë brenda 2 muajve. Pas kësaj, presidenti njofton sekretarin ekzekutiv të KEE, i cili bën caktimin brenda 2 muajve më pas.

- f. Vendosja e niveleve fillestare dhe kritereve më të specifikuar për përcaktimin e rëndësisë të ndikimeve ndërkufitare në lidhje me vendosjen natyrën, madhësinë e veprimtarive të propozuara, për të cilat do të aplikohen vlerësimi i ndikimit të mjedisit në përputhje me kushtet e kësaj Konvente; dhe vendosja e ngarkesave kritike për ndotjen ndërkufitare.
- g. Kur duhet, do të ndërmerren vlerësimi i ndikimit të mjedisit, zhvillimi i programeve të bashkuara të monitorimit, ndëkalibrimi i mjeteve monitoruese dhe harmonizimi i metodologjive.

SHTOJCA VII

ARBITRAZHI

1. Pala ose Palët pretenduese do të njoftojnë sekretariatit që Palët ranë dakort t'a paraqesin debatin e arbitrazhit, sipas nenit 15,2 të kësaj Konvente. Njoftimi do të japë subjektin e arbitrazhit dhe përfshijë në veçanti nenet e kësaj Konvente, interpretimi ose aplikimi i të cilave është në diskutim. Sekretariati do t'ia paraqesë informacionin e marrë gjithë Palëve të Konventës.

2. Trupi gjykues i arbitrazhit do të përbëhet nga 3 anëtarë. Edhe pala pretenduese edhe pala tjetër në debat do të caktojnë nga një gjykues dhe të dy gjykatësit me marrëveshje të përbashkët do të caktojnë gjykatësin e tretë që do të jetë presidenti i trupit gjykues. Ky i fundit nuk duhet të jetë nga vendi i njëjës nga Palët në debat, nuk duhet të banojë në territorin e njëjës nga këto Palë,

as të jetë punësuar nga ndonjëra prej tyre, as të jetë marrë me rastin në ndonjë funksion tjetër.

3. Në qoftë se presidenti i trupit gjykues nuk është caktuar brenda dy muajve nga caktimi i gjykatësit të dytë, Sekretari ekzekutiv i KEE, me kërkesë të çdonjërës nga Palët në debat cakton presidentin brenda një periudhe dy mujore të mëtejshme.

4. Në qoftë se njëra nga Palët debatuese nuk cakton gjykatësin brenda 2 muajve nga marrja e kërkesës, pala tjetër mund të informojë Sekretarin ekzekutiv të KEE, i cili cakton presidentin brenda 2 muajve më pas. Me t'u caktuar, presidenti i trupit gjykues do t'i kërkojë Palës që nuk e ka caktuar gjykatësin ta bëjë këtë brenda 2 muajve. Pas kësaj, presidenti njofton sekretarin ekzekutiv të KEE i cili bën caktimin brenda 2 muajve më pas.

5. Trupi gjykues i jep vendimin e tij në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe klishtet e kësaj Konvente.

6. Çdo trup gjykues i ngritur sipas kushteve të dhëna këtu do të nxjerrë rregullat e veta proceduriale.

7. Vendimet e trupit gjykues të arbitrazhit, si mbi procedurën edhe mbi përmbajtjen merren me shumicë nga anëtarët.

8. Trupi mund të marrë gjithë masat e duhura për të ndërtuar faktet.

9. Palët debatuese do të lehtësojnë punën e trupit gjykues dhe duke përdorur gjithë mjetet në dispozicion do të:

- a. Sigurojnë atë me gjithë dokumentat përkatëse, lehtësitë e informacionin.
- b. Do të bëjë të mundur, kur duhet, thirrjen e dëshmitarëve e ekspertëve dhe merr dëshmitë e tyre.

10. Palët dhe gjykuesit do të mbrojnë sekretin e çdo informacioni të dhënë në konfidencë gjatë procedurave të trupit gjykues.

11. Trupi gjykues i arbitrazhit mund me kërkesë të njëres nga Palët të rekomandojë masa të përkohshme mbrojtëse.

12. Nëse njëra nga Palët debatuese nuk paraqitet para trupit gjykues ose nuk mund të mbrojë rastin e saj, pala tjetër mund t'i kërkojë trupit të vazhdojë procedurat dhe të japë vendimin përfundimtar. Mungesa e njëres Palë ose mos mbrojtja e rastit nga tjetra nuk i pengon procedurat. Para se të japë vendim final, trupi gjykues duhet të jetë i kënaqur që pohimi që i bazuar në ligje e fakte.

13. Trupi gjykues mund të dëgjojë e përcaktojë kundërpretendimet që dalin drejtpërdrejtë nga përmbajtja e debatit.

14. Nëse trupi gjykues nuk përcakton ndryshe për shkak të rrethanave të veçanta të çështjes, shpenzimet e trupit do të bëhen barabar nga Palët në debat. Trupi do të mbajë shënim gjithë shpenzimet e tij dhe do të bëjë deklaratën përfundimtare të Palët.

15. Çdo Palë e kësaj Konvente që ka interes të një natyre ligjore në përmbajtjen e debatit që mund të preket nga një vendim i çështjes, mund të ndërhyjë në procedurat me leje të trupit gjykues.

16. Trupi gjykues do t'a japë vendimin e tij brenda 5 muajve nga data që u mor, në qoftë se nuk e sheh të arsyeshme t'a zgjatë kufirin kohor për një periudhë që nuk i kalon 5 muajt.

17. Vendimi i trupit gjykues do të shoqërohet nga një deklaratë me arsyet përkatëse. Ai duhet të jetë përfundimtar dhe përfshijë gjithë Palët debatuese. Vendimi do t'i transmetohet nga trupi gjykues Palëve debatuese dhe sekretariatit. Sekretariati do t'ia paraqesë gjithë informacionin e marrë Palëve në Konventë.

18. Çdo debat që mund të lindë mes Palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e vendimit, mund të paraqitet nga secila Palë në trupin gjykues që e mori vendimin, ose të një trup tjetër i ngritur për këtë qëllim në të njëjtën mënyrë si i pari.

Ky dokument është hartuar për të shërbyer plotësisht si instrument dokumentacioni dhe institucionet nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për përmbajtjen e tij

DIREKTIVA E KËSHILLIT
27 qershor 1985
mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve
publike dhe private mbi mjedisin

(85/337/EEC)

(OJ L 175, 5.7.1985, p. 40)

E amenduar nga:

	Gazeta Zyrtare		
	Nr	faqe	datë
Direktiva e Këshillit 97/11/EC e 3 marsit 1997	L 73	5	14.3.1997
Direktiva 2003/35/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e dt 26 maj 2003	L 156	17	25.6.2003

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EVROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin në bazë të së cilit është themeluar Komuniteti Ekonomik Evropian, dhe në veçanti Nenet 100 dhe 235 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit²⁵,

Duke pasur parasysh mendimin e Parlamentit Evropian²⁶ (2),

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social²⁷ (3),

Në bazë të programeve të veprimeve të 1973²⁸ (4) dhe 1977²⁹ (5) të Komuniteteve Evropiane mbi mjedisin si dhe programin e veprimit të 1983³⁰ (6), pikat kryesore

²⁵ GZ nr C 169, 9. 7. 1980, f. 14

²⁶ GZ nr C 66, 15. 3. 1982, f. 89.

²⁷ GZ nr C 185, 27. 7. 1981, f. 8.

²⁸ GZ nr C 112, 20. 12. 1973, f. 1.

²⁹ GZ nr C 139, 13. 6. 1977, f. 1.

³⁰ GZ nr C 46, 17. 2. 1983, f. 1

të të cilave janë miratuar nga Këshilli i Komuniteteve Evropiane dhe përfaqësuesit e Shteteve Anëtare, thekson se politika më e mirë mjedisore përbëhet prej parandalimit të ndotjes ose problemeve të tjera në burim, më tepër sesa prej përpjekjeve për të reaguar ndaj efekteve të tyre; ndërkohë që afirmohet nevoja për të marrë masa për mbrojtjen e mjedisit në etapën më të hershme të mundshme në të gjitha proceset e planifikimit teknik dhe të vendimmarrjes, dhe, për këtë qëllim, parashikohen dhe procedurat për të vlerësuar efekte të tilla;

Ndërkohë që pabarazitë ndërmjet ligjeve në fuqi në Shtete të ndryshme Anëtare përsa i përket vlerësimit të efekteve mjedisore të projekteve publike dhe private mund të krijojnë kushte jo të përshtatshme dhe, si rezultat mund të ndikojnë drejtpërsëdrejti mbi funksionimin e tregut të përbashkët; si pasojë është e nevojshme që të përafrohen ligjet kombëtare në këtë fushë në bazë të Nenit 100 të Traktatit;

Ndërkohë që, për më tepër, është e nevojshme që të arrihet një ndër objektivat e komunitetit në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të cilësisë së jetës;

Ndërkohë që, përderisa Traktati nuk parashikon kompetencat e nevojshme për këtë qëllim, burimet duhet të përcaktohen në bazë të Nenit 235 të Traktatit;

Ndërkohë që duhet të prezantohen parimet e përgjithshme për vlerësimin e efekteve mjedisore në mënyrë që të shtohen dhe të koordinohen procedurat e zhvillimit konsensual që drejtojnë projekte publike dhe private që ka të ngjarë që të kenë një efekt të madh mbi mjedisin;

Ndërkohë që duhet të merret pëlqimi për zhvillimin e projekteve publike dhe private të cilat mendohet që të kenë efekte të mëdha mbi mjedisin vetëm pas bërjes së vlerësimeve paraprake të efekteve domethënëse të mundshme mjedisore; ndërkohë që ky vlerësim duhet të bëhet mbi bazën e informacionit të duhur të dhënë nga zhvilluesi, i cili mund të plotësohet nga autoritete dhe nga njerëzit të interesuar për projektin në fjalë;

Ndërkohë që parimet e vlerësimit të efekteve mjedisore duhet të harmonizohen, në veçanti në lidhje me referencën që i bëhet projekteve, të cilat janë subjekt i vlerësimit, dhe me detyrimet kryesore të zhvilluesve dhe të përmbjatjes së vlerësimit;

Ndërkohë që projektet e llojeve të ndryshme kanë efekte domethënëse mbi mjedisin dhe këto projekte si rregull duhet të jenë subjekt i vlerësimit sistematik;

Ndërkohë që projekte të llojeve të tjera mund të mos kenë efekte domethënëse mbi mjedisin në çdo rast, dhe ndërkohë që këto projekte duhet të vlerësohen kur të gjykohet nga Shtetet Anëtare se një gjë e tillë është e nevojshme për karakteristikat e tyre;

Ndërkohë që duhet të jepet një sasi minimale informacioni për projekte të cilat janë subjekt i vlerësimit në lidhje me projektin dhe efektet e tij;

Ndërkohë që duhet të vlerësohen efektet e projektit mbi mjedisin në mënyrë që të merren parasysh shqetësimet për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, për të kontribuar për një cilësi më të mirë jetese nëpërmjet një mjedisi më të mirë, për të siguruar ruajtjen e diversitetit të specieve dhe për të ruajtur kapacitetin riprodhues të ekosistemit si burim bazë jete;

Ndërkohë që kjo direktivë nuk duhet të aplikohet për projektet, detajet e të cilëve janë miratuar nga një akt i veçantë i legjislacionit kombëtar, përderisa objektivat e kësaj Direktive, duke përfshirë dhe ofrimin e informacionit, janë arritur nëpërmjet procesit legjislativ;

Ndërkohë që, për me tepër, në raste përjashtimore, mund të jetë me vend që të përjashtohet një projekt specifik nga procedurat e vlerësimit të parashtruara në këtë Direktivë, duke qenë subjekt i informacionit përkatës që i dorëzohet Komisionit,

MIRATOI KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

1. Kjo Direktivë do të aplikojë vlerësimin e efekteve mjedisore në ato projekte publike dhe private të cilat mund të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin.

2. Në kuptimin e kësaj Direktive:

‘projekti’ nëkupton:

- ekzekutimin e punëve të ndërtimit ose të instalimeve ose skemave të tjera,
- ndërhyrje të tjera në rrethinat natyrore dhe në mjedis, duke përfshirë dhe nxjerrjen e burimeve minerale;

‘zhvilluesi’: aplikanti për autorizim për një projekt privat ose publik, ose autoriteti publik që fillon një projekt;

‘pëlqimi për zhvillim’ është vendimi i autoritetit ose autoriteteve kompetente që i lejon zhvilluesit që të vazhdojë projektin;

‘publik’ është: një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, dhe, në përputhje me legjislacionin ose praktikën kombëtare, shoqatat, organizatat ose grupet e tyre;

‘publiku në fjalë’ është: publiku i prekur ose që ka të ngjarë që të preket nga, ose i cili ka interes në procedurat vendimmarrëse mjedisore të cilave u referohet Neni 2(2); për qëllim të këtij përkufizimi, organizatat jo-qeveritare që promovojnë mbrojtjen mjedisore dhe që plotësojnë të gjitha kërkesat e parashtruara në ligjit kombëtar, do të konsiderohen si organizma që kanë interes.

3. Autoriteti ose autoritete kompetente janë ato autoritete të cilat përcaktohen nga Shtetet Anëtare si përgjegjëse për realizimin e detyrave që dalin nga kjo Direktivë.

4. Nëse parashikohet në ligjin kombëtar, në bazë të rasteve, Shtetet Anëtare mund të vendosin që të mos

aplikojnë këtë direktivë për projektet e hartuar për qëllime të mbrojtjes kombëtare, nëse gjykohet se një aplikim i tillë do të ketë efekt të papërshtatshëm mbi këto qëllime.

5. Kjo Direktivë nuk do të aplikohet për projekte, detajet e të cilëve janë miruar nga një akt i veçantë i legjislacionit kombëtar, përderisa objektivat e kësaj Direktive, duke përfshirë dhe ofrimin e informacionit, arrihen nëpërmjet procesit legjislativ.

Neni 2

1. Shtetet Anëtare do të miratojnë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se, përpara dhënies së pëlqimit, projektet që ka mundësi që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin, *inter alia*, për shkak të natyrës, madhësisë ose vendndodhjes janë subjekt i kërkesave për pëlqim të zhvillimit dhe vlerësimit të efekteve të tyre. Këto projekte janë përcaktuar në Nenin 4.

2. Vlerësimi i ndikimit të mjedisit mund të integrohet në procedurat ekzistuese për pëlqim për projektet në Shtete Anëtare, ose, nëse nuk i përket kësaj kategorie, në procedura të tjera ose në procedura që do të përcaktohen për t'u përputhur me qëllimet e kësaj direktive.

2a. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë një procedurë të vetme në mënyrë që të plotësohen kërkesat e kësaj Direktive dhe kërkesat e Direktivës së Këshillit 96/61/EC të 24 shtatorit 1996 mbi parandalimin dhe kontrollin e ndotjes së integruar³¹ (1).

3. Pa paragjykuar Nenin 7, Shtetet Anëtare, në raste përjashtimore, mund të përjashtojnë një projekt të caktuar në tërësi ose pjesërisht nga dispozitat e parashikuara në këtë Direktivë. në këtë rast, Shtetet Anëtare duhet të:

- a. shqyrtojnë nëse do të ishte e përshtatshme një tjetër formë vlerësimi;

³¹ GZ L 257, 10. 10. 1996, f. 26.

- b. ofrojnë informacionin e marrë nga formularë të tjerë vlerësimi të cilëve u referohet pika (a) publikut të interesuar – informacion që lidhet me vendimin për përjashtime dhe arësyet për dhënien e tij;
- c. informojnë Komisionin për arësyet që justifikojnë përjashtimin përpara dhënies së pëlqimit, dhe të japin informacionin e disponueshëm, kur ai është i aplikueshëm, për nënshtetasit e tyre.

Komisioni duhet të dërgojë menjëherë dokumentet e marra nga Shtete të tjera Anëtare.

Komisioni duhet të raportojë çdo vit në Këshill për aplikimin e këtij paragrafi.

Neni 3

Vlerësimi i ndikimit të mjedisit do të identifikojë, përshkruajë dhe vlerësojë në mënyrën e duhur, në kuadrin e çdo rasti individual, dhe në përputhje me Nenet 4 dhe 11, efektet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të një projekti mbi bazën e faktorëve të mëposhtëm:

- qëniet njerëzore, fauna dhe flora;
- toka, uji, ajri, klima dhe terreni;
- asetet materiale dhe trashëgimia kulturore;
- ndërthurjen ndërmjet faktorëve që përmenden në pikën e parë, të dytë dhe të tretë.

Neni 4

1. Në bazë të Nenit 2 (3), projektet që jepen në listë në Shtojcën I do të jenë subjekt i një vlerësimi në përputhje me Nenin 5 deri në Nenin 10.

2. Në bazë të Nenit 2 (3), për projektet e dhëna në listë në Shtojcën II, Shtete Anëtare do të vendosin në bazë të:

- (a) shqyrtimit rast pas rasti, ose

- (b) pragjeve ose kritereve të përcaktuara nga Shtetet Anëtare nëse projekti do të jetë subjekt i një vlerësimi në bazë të Nenit 5 deri në Nenin 10.

Shtetet Anëtare mund të vendosin që të aplikojnë të dyja procedurat të cilave u referohet pika (a) dhe (b).

3. Kur bëhet një shqyrtim në bazë rasti, ose në rastet kur janë përcaktuar pragje ose kritere për qëllimet e paragrafit 2, duhet të merren parasysh kriteret përkatëse përzgjedhëse të parashtruara në Shtojcën III.

4. Shtetet Anëtare duhet të sigurohen se përcaktimi i bërë nga autoritete kompetente në paragrafin 2 të bëhet publik.

Neni 5

1. Në rastet e projekteve të cilat, në bazë të Nenit 4, duhet të bëjnë vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin, në përputhje me parashikimet e Nenit 5 deri në Nenin 10, Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar se zhvilluesi e jep informacionin e specifikuar në Shtojcën IV në formatin e përshtatshëm, dhe në mënyrë që:

- (a) Shtetet Anëtare të gjykojnë që informacioni është i përshtatshëm në një etapë të caktuar të procedurës së pëlqimit dhe në përputhje me karakteristikat e veçanta të një projekti të veçantë ose të një lloji projekti dhe përmban tipare mjedisore që mund të preken;
- (b) Shtetet Anëtare mendojnë se mund të kërkohet një zhvillues për të mbledhur këtë informacion, duke pasur parasysh, *inter alia*, njohuritë aktuale dhe metodat e vlerësimit.

2. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar se nëse zhvilluesi i kërkon autoritetit kompetent përpara dorëzimit të aplikimit të japë një mendim mbi informacionin që atij i duhet të japë në përputhje me paragrafin 1, autoriteti kompetent ta japë mendimin e kërkuar. Autoriteti kompetent do të konsultohet me zhvilluesin dhe me autoritetet e

përmendura në Nenin 6 (1) përpara se ai të japë mendim. Fakti që autoriteti ka dhënë një mendim në bazë të këtij paragrafi, nuk do ta përjashtojë atë nga mundësia për t'i kërkuar zhvilluesit të japë informacion të mëtejshëm .

Shtetet Anëtare mund t'u kërkojnë autoriteteve kompetente që të japin mendimin e tyre, pavarësisht nëse zhvilluesi e kërkon këtë informacion ose jo.

3. Informacion që do të ofrohet nga zhvilluesi në përputhje me paragrafin 1, do të përfshijë të paktën:

- një përshkrim të projektit që përmban informacion mbi vendndodhjen, skicën dhe madhësinë e projektit,
- një përshkrim të masave të parashikuara në mënyrë që të shmangen, të ulen, ose, nëse është e mundur, të ndreqen efektet domethënëse të papërshtatshme,
- të dhënat e kërkuara për të identifikuar dhe për të vlerësuar efektet kryesore që do të ketë projekti mbi mjedisin,
- një përmbledhje të alternativave kryesore të studiuara nga zhvilluesi dhe një tregues të arsyeve kryesore për përzgjedhjen e tij, duke marrë parasysh efektet mjedisore,
- një përmbledhje jo-teknike të informacionit të përmendur në pjesët e mëparshme.

4. Nëse është e nevojshme, Shtetet Anëtare do të sigurojnë se çdo autoritet që ka informacionin përkatës, veçanërisht informacionin që përmendet në Nenin 3, duhet t'ia japë këtë informacion të disponueshëm zhvilluesit.

Neni 6

1. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar se autoritetet që ka mundësi që të shqetësohen nga projekti si rezultat i përgjegjësisë të tyre specifike mjedisore t'u jepet mundësia që të shprehin mendimin e tyre mbi informacionin e dhënë nga zhvilluesi dhe me kërkesë për pëlqim zhvillimi. Për këtë arsye, Shtetet Anëtare do të përcaktojnë autoritetet që do të konsultohen, ose në terma të përgjithshme ose në bazë individuale. Informacioni i mbledhur sipas parashikimeve të Nenit 5 do t'u jepet këtyre autoriteteve. Rregullime të detajuara për konsultim do të parashtrihen nga Shtetet Anëtare.

2. Publiku do të informohet nëpërmjet njoftimeve publike ose medias elektronike në rastet kur kjo e fundit është e disponueshme për çështjet e mëposhtme që në fillimet e procedurave vendimmarrëse mjedisore të specifikuar në Nenin 2(2), ose në rastin më të vonë atëherë kur të jepet informacioni për:

- (a) kërkesën për pëlqimin e zhvillimit;
- (b) faktin që projekti është subjekt i procedurës së vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe, kur të jetë e përshtatshme, faktin që aplikohet Neni 7;
- (c) detaje të autoriteteve kompetente përgjegjëse për marrjen e vendimit, të autoriteteve prej nga mund të merret informacioni përkatës, autoritetet tek të cilat drejtohen komente ose pyetje, si dhe detaje të kohës për transmetimin e komenteve ose të pyetjeve;
- (d) natyrën e vendimeve të mundshme, ose të draft vendimit, nëse ekziston një i tillë;
- (e) një tregues të disponueshmërisë së informacionit të mbledhur në bazë të Nenit 5;
- (f) një tregues të kohëve dhe të vendeve si dhe mënyrave nëpërmjet të cilave do të bëhet i disponueshëm informacioni përkatës;
- (g) detaje të rregullimeve për pjesëmarrjen publike, sipas paragrafit 5 të këtij Neni.

3. Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që, brenda afateve kohore të arsyeshme, publikut t'i bëhet me dije:

- (a) çdo informacion i mbledhur në bazë të Nenit 5;
- (b) në përputhje me legjislacionin kombëtar, raportet kryesore, si dhe këshillat që i janë dhënë autoritetit/autoriteteve kompetente në kohën kur publiku i interesuar është informuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni;
- (c) në përputhje me dispozitat e Direktivës 2003/4/EC së Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të nxjerra më 28 janar 2003 mbi aksesin e publikut mbi informacionin mjedisor³² (1), të japë informacion të ndryshëm nga informacioni të cilit i referohet paragrafi 2 i këtij Neni, i cili është i përshtatshëm për vendimin, në përputhje me Nenin 8, dhe i cili bëhet i disponueshëm pas kohës kur publiku i interesuar është informuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni.

4. Publikut të interesuar duhet t'i jepen që herët mundësitë efektive për të marrë pjesë në procedurat mjedisore vendimmarrëse të cilave u referohet Nenin 2(2), dhe, për këtë qëllim, do të ketë të drejtë që të ai të shprehë komente dhe opinione, dhe të gjitha mundësitë do të jenë të hapura për autoritetin ose autoritetet kompetente përpara vendimit për kërkesën për marrjen e pëlqimit për zhvillimin.

5. Rregullimet e detajuara për informimin e publikut (për shembull nëpërmjet njoftimeve brenda një rrezeje të caktuar ose botimit në gazetatat lokale) dhe për t'u konsultuar me publikun e prekur (për shembull nëpërmjet materialeve të shkruara ose sondazheve të publikut) do të përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

6. Do të parashikohen afate kohore të arsyeshme për faza të ndryshme, duke lejuar kohë të mjaftueshme për të informuar publikun dhe për të lejuar publikun e interesuar që të përgatisë dhe të marrë pjesë në mënyrë

³² OJ L 41, 14.2.2003, p. 26

efektive në vendimmarrjen mjedisore, që është subjekt i dispozitave të këtij Neni.

Neni 7

1. Kur një Shtet Anëtar është i ndërgjegjshëm se një projekt ka efekte domethënëse mbi mjedisin e një Shteti tjetër Anëtar, ose kur kërkohet nga një Shtet Anëtar që ka mundësi të preket, Shteti Anëtar në territorin e të cilit mendohet që të zbatohet projekti, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë sesa koha e informimit të publikut të tij, *inter alia* do t'i dërgojë Shtetit të prekur Anëtar:

- (a) një përshkrim të projektit, sëbashku me çdo informacion tjetër të disponueshëm mbi ndikimin e mundshëm ndërkufitar të projektit;
- (b) informacion mbi natyrën e vendimit që mund të merret, dhe duhet t'i japë Shtetit Anëtar kohë të mjaftueshme për të treguar nëse ai dëshiron që të marrë pjesë në procedurat mjedisore vendimmarrëse të cilave u referohet Nenin 2(2), dhe mund të përfshihet informacioni të cilit u referohet paragrafi 2 i këtij Neni.

2. Nëse një Shtet Anëtar i cili merr informacion në bazë të paragrafit 1, dëshmon që ai synon që të marrë pjesë në procedurat vendimmarrëse mjedisore të cilave u referohet Nenin 2 (2), Shteti Anëtar në territorin e të cilit mendohet që të zbatohet projekti, nëse nuk e ka dërguar më përpara, duhet t'i dërgojë Shtetit Anëtar të prekur informacionin që nevojitet sipas Nenit 6(2) dhe ta bëjë të disponueshëm sipas nenit 6(3)(a) dhe (b).

3. Shtetet Anëtare të interesuara/prekura, gjithashtu duhet të:

- (a) bëjnë rregullimet për të siguruar informacionin që përfshihet në paragrafin 1 dhe 2 brenda një kohe të arsyeshme dhe t'ia japin atë autoriteteve që specifikohen në Nenin 6(1) dhe publikut të interesuar në territorin e shteteve

Anëtare, ose publikut që ka të ngjarë që të preket prej projektit, dhe

- (b) sigurojnë që autoriteteve dhe publikut të interesuar t'u jepet mundësia që t'i japin autoriteteve përkatëse të Shteteve Anëtare ku mendohet që të zbatohet projekti mendimin e tyre brenda një kohe të arsyeshme përpara dhënies së pëlqimit për projektin.

4. Shtetet Anëtare të interesuara do të hyjnë në konsultime *inter alia* në lidhje me efektet ndërkufitare të projektit dhe masat e parashikuara për të ulur ose eliminuar efekte të tilla dhe do të bihet dakort për një afat kohor të arsyeshëm për zgjatjen e periudhës së konsultimit.

5. Rregullimet e detajuara për zbatimin e këtij Neni mund të përcaktohen nga Shtetet Anëtare të interesuara, dhe do të bëhen në mënyrë të tillë që t'i lejojnë publikut të interesuar në Shtetet Anëtare që të marrë pjesë efektivisht në procedurat mjedisore vendimmarrëse të cilave u referohet Nenin 2(2) për projektin.

Neni 8

Rezultatet e konsultimeve dhe të informacionit të mbledhur në bazë të Neneve 5, 6 dhe 7 duhet të merren parasysh gjatë zhvillimit të procedurës së pëlqimit.

Neni 9

1. Kur të merret vendimi për të dhënë ose refuzuar pëlqimin për zhvillimin e projektit, autoriteti ose autoritetet kompetente do të informojnë publikun në përputhje me procedurat e duhura dhe do t'i ofrojnë publikut informacionin e mëposhtëm:

- përmbajtjen e vendimit dhe të gjitha kushtet e përfshira në të,
- pas shqyrtimit të shqetësimeve dhe të opinioneve të shprehura nga publiku i interesuar, arsyet dhe konsideratat kryesore mbi të cilat është bazuar vendimi, duke

përfshirë informacion rreth procesit të pjesëmarrjes së publikut,

- një përshkrim, aty ku është i nevojshëm, të masave kryesore për të shmangur, ulur, dhe, nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative.

2. Autoriteti ose autoritete kompetente do të informojnë çdo Shtet Anëtar i cili është konsultuar në përputhje me Nenin 7, duke i dhënë atij informacionin të cilit i referohet paragrafi 1 i këtij Neni.

Shtetet Anëtare të konsultuara do të sigurojnë që informacioni të bëhet i disponueshëm në mënyrën e duhur tek publiku i interesuar në territoret e tyre përkatëse.

Neni 10

Dispozitat e kësaj Direktive nuk do të kenë ndikim mbi autoritetet kompetente për të respektuar kufizimet e parashtruara në legjislacionet kombëtare dhe dispozitat administrative dhe praktikat ligjore të pranuarra përsa i përket konfidencialitetit komercial dhe industrial, duke përfshirë dhe pronësinë intelektuale dhe ruajtjen e interesit publik.

Kur aplikohet Neni 7, transmetimi i informacionit në një tjetër Shtet Anëtar dhe marrja e informacionit nga një tjetër Shtet Anëtar do të jetë subjekt i kufizimeve në fuqi në Shtetet Anëtare në të cilat është propozuar projekti.

Neni 10a

Shtetet Anëtare do të sigurohen që, në përputhje me sistemin përkatës ligjor kombëtar, anëtarët e publikut:

- (a) që kanë një interes të mjaftueshëm, ose ,
- (b) që mund të dëmtojnë një të drejtë, në rastet kur e drejta procedurale administrative e një Shteti Anëtar e kërkon këtë gjë si parakusht,

kanë akses në një procedurë rishikimi përpara një gjykate ose përpara ndonjë organizmi tjetër të pavarur dhe të paanshëm, i përcaktuar me ligj për të sfiduar ligjshmërinë substantive ose procedurale të vendimeve, akteve ose rishikimeve që janë subjekt i dispozitave të pjesëmarrjes së publikut në këtë Dispozitë.

Shtetet Anëtare do të përcaktojnë se në çfarë etape mund të sfidohen vendimet, aktet apo rishikimet.

Ajo çfarë përbën interes të mjaftueshëm dhe dëmtrim të së drejtës do të përcaktohet nga Shtetet Anëtare në mënyrë të vazhdueshme, me objektivin e dhënies së një aksesit të gjërë drejtësie tek publiku i interesuar. Për këtë qëllim, interesi i çdo organizate jo-qeveritare që plotëson kërkesat të cilave u referohet Neni 1(2) do të konsiderohet si të mjaftueshme për qëllimet e nënparagrafit (a) të këtij Neni.

Dispozitat e këtij Neni nuk do të përjashtojnë mundësinë e një procedure fillestare rishikimi përpara një autoriteti administrativ dhe nuk do të kenë ndikim mbi kërkesat e realizimit të procedurave rishikuese administrative përpara fillimit të procedurave rishikuese gjyqësore, ku ekziston një kërkesë e tillë sipas ligjit kombëtar.

Çdo procedurë e tillë duhet të jetë e barabratë, e drejtë, duhet të shërbehet në kohë dhe nuk duhet të jetë aq e shtrenjtë sa të pengojë ushtrimin e saj.

Në mënyrë që të çohet më tej efektiviteti i dispozitave të këtij neni, Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që informacioni praktik i lidhur me aksesin në procedurat e rishikimit administrativ dhe gjyqësor të bëhet i njohur për publikun.

Neni 11

1. Shtetet Anëtare dhe Komisioni do të shkëmbejnë informacion mbi eksperiencën e marrë gjatë aplikimit të kësaj Direktive.

2. Në veçanti, Shtetet Anëtare do të informojnë Komisionin për kriteret dhe/ose pragjet e vendosura për

përzgjedhjen e projekteve në fjalë, në përputhje me Nenin 4(2).

3. Pesë vjet pas njoftimit të kësaj Direktive, Komisioni do t'i dërgojë Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport mbi aplikimin dhe efektivitetin e saj. Raporti do të bazohet në shkëmbimin e informacionit të lartpërmendur.

4. Mbi bazën e këtij shkëmbimi informacioni, Komisioni do t'i dërgojë Këshillit propozime shtesë, nëse një procedurë e tillë është e nevojshme, me synimin e aplikimit të kësaj Direktive në një mënyrë mjaftueshmërisht të koordinuar.

Neni 12

1. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të respektuar pikat e kësaj Direktive brenda tre vjetësh nga njoftimi i saj³³ (1).

2. Shtetet Anëtare do t'i komunikojnë Komisionit tekstet e dispozitave të ligjit kombëtar të cilat ata do të miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë.

Neni 14

Kjo Direktivë i drejtohet Shteteve Anëtare.

³³ Kjo Direktivë iu njoftua Shteteve Anëtarë më 3 qershor 1985

SHTOJCA I

PROJEKTET QË JANË SUBJEKT I NENIT 4 (1)

1. Rafineritë më bazë naftë të papërpunuar (duke përjashtuar ndërmarrjet që prodhojnë vetëm lubrifikantë nga naftë e papërpunuar) dhe instalimet për gazifikimin ose lëngëzimin e 500 tonë ose më tepër qymyr ose benoniumi në ditë.

2. Termocentrale ose instalime të tjera djegëse me një prodhim njetësie prej 300 ose më shumë mega vatësh, dhe

Stacionet e energjisë nukleare dhe reagues të tjerë nuklearë duke përfshirë dhe çmontimin ose dekomisionimin e stacioneve ose reaguesve të tillë³⁴ (*) (në përjashtim të instalimeve kërkimore për prodhimin dhe konvertimin e materialeve të zërthyeshme ose pjellore, fuqia maksimale e të cilave nuk e tejkalon ngarkesën termale të vazhdueshme prej 1 kilovati).

3.

(a) Instalimet për riprodhimin e karburantit nuklear të parrezatuar.

(b) Instalimet e hartuara për:

- prodhimin ose pasurimin e karburantit nuklear,
- për përpunimin e karburantit të parrezatuar nuklear ose mbetjeve me nivel të lartë radioaktiv,

(*) Stacionet e energjive nukleare dhe reagues të tjerë nuklearë nuk janë më instalime të tilla kur lëndët nukleare dhe elementë të tjerë radioaktivë të kontaminuar hiqen në mënyrë të vazhdueshme nga vendi i instalimit

(¹) Në kuptimin e kësaj Direktive, 'aeropotet' janë aeroporte të cilat përputhen me përkufizimin e dhënë në Konventën e 1944-ës në Çikago ku dhe u themelua Organizata Ndërkombëtare Civile e Aviacionit (Shtojca 14).

(²) Në kuptimin e kësaj Direktive, 'rrugë ekspres' është një rrugë që plotëson kushtet e dhëna në përkufizimin e Marrëveshjes Europiane mbi Arteriet Kryesore të Trafikut Ndërkombëtar, 15 nëntor 1975.

- për hedhjen përfundimtare të lëndës irradiated nukleare,
- vetëm për hedhje përfundimtare të mbetjeve radioaktive,
- vetëm për ruajtjen (e planifikuar për më tepër se 10 vjet) të lëndëve të parrezatuara nukleare ose mbetjeve radioaktive në një vend të ndryshëm nga vendi i prodhimit.

4. Vepra të integruara për shkrirjen fillestare të hekurit dhe të çelikut;

Instalime për prodhimin e metaleve jo-çelikore nga xeheroreve, koncentrate ose materiale dytësore nëpërmjet proceseve metalurgjike, kimike ose elektrolitike.

5. Instalime për nxjerrjen e asbestit dhe për përpunimin ose transformimin e asbestos and produkteve që përmbajnë këtë komponent, për një prodhim vjetor prej më tepër se 20 000 tonë të prodhimeve të përfunduara, për materiale rezistente me një prodhim vjetor prej më shumë se 50 tonë të produkteve të përfunduara, dhe për përdorime të tjera të asbestos, duke përdorur më tepër se 200 tonë në vit.

6. Instalime të integruara kimike, dmth instalime për prodhimin e substancave duke përdorur procese të konvertimit kimik, në të cilat shumë njësi janë vendosur sëbashku dhe janë të lidhura funksionalisht me njëra-tjetrën dhe që shërbejnë për:

- (i) prodhimin e kimikateve bazë organike;
- (ii) prodhimin e kimikateve bazë joorganike;
- (iii) për prodhimin e plehrave kimikë me bazë fosfori, nitrogjeni, ose potasiumi (fertilizatorë të thjeshtë ose të përbërë);
- (iv) për prodhimin e produkteve dhe biocideve bazë për shëndetin e bimëve;
- (v) për prodhimin e produkteve bazë farmaceutike duke përdorur një proces kimik ose biologjik;
- (vi) për prodhimin e eksplozivëve.

7.

- (a) Ndërtimi i linjave për trafik hekurudhor me distanca të gjata dhe të aeroporteve ⁽¹⁾ me një gjatësi bazë prej 2 100 m ose më tepër;
- (b) Ndërtimi i autostradave dhe rrugëve ekspres ⁽²⁾;
- (c) Ndërtimi i një rruge të re me katër ose më tepër korsi, ose rregullimi dhe/ose zgjerimi i një rruge ekzistuese në mënyrë që të përfshihen katër ose më tepër korsi, dhe ku një rrugë e re e tillë, ose një seksion i rregulluar dhe/ose i zgjeruar rruge do të jetë 10 kilometra ose më tepër në një gjatësi të vazhdueshme.

8.

- (a) rrugë ujore në brendësi të tokës dhe porte për të realizuar trafikun nëpërmjet detit, duke u lejuar pasagjerët që të përdorin deri në 1 350 tonë;
- (b) Portet tregëtare, kalatat për ngarkim-shkarkim të lidhura me tokën dhe portet e jashtme (duke përfshirë kalatat e trageteve) të cilat mund të mbajnë anije prej më shumë se 1350 tonësh.

9. Instalime në vendet e hedhjes së mbeturinave për të djegur dhe për të bërë trajtimin kimik të përcaktuar në Shtojcën IIA të Direktivës 75/442/EEC ⁽¹⁾ nën titullin D9, ose vend-depozitimi i mbetjeve të rrezikshme (dmth mbetjeve të cilave u referohet Direktiva 91/689/EEC ⁽²⁾).

10. Instalime në vend-depozitimin e mbeturinave për djegjen ose trajtimin kimik siç përcaktohet në Shtojcën IIA të Direktivës 75/442/EEC nën titullin D9 e mbetjeve jo të rrezikshme me një kapacitet që i tejkalon 100 tonë në ditë.

11. Nxjerrja e ujit nëntokësor ose skema të nxjerrjes artificiale të ujit nëntokësor ku volumi vjetor i ujit të nxjerrë është ekuivalent me ose më tepër se 10 milionë metra kubë.

12.

- (a) Veprat për transferimin e burimeve ujore ndërmjet baseneve ujore ku ky transferim synon në

parandalimin e mungesave të mundshme të ujit dhe ku masa e ujit të transferuar e kalon nivelin prej 100 milionë metra kubë në vit;

- (b) Në të gjitha rastet e tjera, punët për transferimin e burimeve ujore ndërmjet baseneve ujore ku rrjedha mesatare shumë-vjetore e basenit të nxjerrjes është me e madhe se 2 000 milionë metra kubë/në vit dhe ku masa e ujit të transferuar e tejkalon nivelin e 5 % të kësaj rrjedhe.

Në të dyja rastet, përjashtohen transferimet e tubacioneve të ujit të pijshëm.

13. Impiantet e trajtimit të mbetjeve ujore me një kapacitet që e tejkalon ekuivalentin e popullsisë prej 150 000 banorësh, ashtu siç përcaktohet në Nenin 2, pika (6) në Direktivën (91/271/EEC ⁽³⁾).

14. Ndjerrja e petroliumit dhe gazit natyror për qëllime tregëtare, ku masa e nxjerrë e tejkalon nivelin prej 500 tonë në ditë në rastin e petroliumit dhe 500 000 m³/ditë në rastin e gazit.

15. Diga dhe instalime të tjera të cilat janë projektuar për të mbajtur ose ruajtur ujë, ku një masë e re ose shtesë e mbajtur ose e ruajtur uji e kalon cakun e 10 milionë metra kubëshit.

16. Tubacionet për transportimin e gazit, naftës ose kimikateve me një diametër prej më shumë se 800 mm dhe një gjatësi prej më shumë se 40 km.

17. Instalime për mbarshtrimin intensiv të pulave ose derrave me më tepër se:

- (a) 85 000 vende për zoçka, 60 000 vende për pulat;
- (b) 3 000 vende për derra për prodhim mishi (mbi 30 kilogramë); ose
- (c) 900 vende për dosa.

18. Impiante industriale për:

- (a) prodhimin e materialeve të buta ose materialeve të ngjashme fibroze;

- (b) prodhimin e letrës dhe tgabelave me një kapacitet prodhues që e kalon masën prej 200 tonësh nën ditë.

19. Miniera të mbyllura ose të hapura ku sipërfaqja e vendit e kalon limitin prej 25 hektarësh, ose vende për nxjerrjen e torfës ku sipërfaqja e vendit është më e madhe se 150 hektarë.

20. Ndërtimi i linjave elektrike me një voltazh më të lartë se 220 KV, dhe me një gjatësi prej më shumë se 15 kilometrash.

21. Instalimet për ruajtjen e petroliumit, prodhimeve petrokimike ose kimike me një kapacitet prej 200 ose më shumë tonësh.

22. çdo ndryshim ose zgjatje projekti ashtu siç parashikohet në këtë Shtojcë, kur një ndryshim ose një zgjatje e tillë e plotëson pragun e caktuar në këtë Shtojcë, nëse një i tillë është i përfshirë.

- (1) GZ nr L 194, 25. 7. 1975, f. 39. Direktiva e amenduar së fundmi nga Vendimi i Komisionit 94/3/EC (GZ nr L 5, 7. 1. 1994, f. 15).
- (2) GZ nr L 377, 31. 12. 1991, f. 20. Direktiva e amenduar së fundmi nga Direktiva 94/31/EC (GZ nr L 168, 2. 7. 1994, f. 28).
- (3) GZ nr L 135, 30. 5. 1991, p. 40. Direktiva e amenduar së fundmi nga Akti i Pranimi i 1994-ës.

SHTOJCA II

Projektet që janë subjekt i nenit 4 (2)

1. Bujqësia, sulvikultura dhe akuakultura

- (a) Projekte për ristrukturimin e mbajtësve të tokës rurale;
- (b) Projekte për përdorimin e tokës së pakultivuar ose zonave gjysëm-natyrore për përdorime intensive bujqësore;

- (c) Projekte për menaxhimin e ujit për bujqësi, duke përfshirë dhe vaditjen dhe projektet për tubacionet në tokë;
- (d) pyllëzimi fillestar dhe shpyllëzimi për qëllimet e ndryshimit në një lloj tjetër të përdorimit të tokës;
- (e) Instalime intensive për gjënë e gjallë (projektet nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
- (f) Rritje intensive e peshkut;
- (g) Marrje e tokës nga deti.

2. Industri nxjerrëse

- (a) Miniera të mbyllura e të hapura dhe nxjerrje e torfës (projektet nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
- (b) Minierat nëntokësore;
- (c) Nxjerrje e mineraleve nga marina ose fundrrinat fluviale;
- (d) Shpim i thellë, në veçanti:
 - shpim gjeotermal,
 - shpim për ruajtjen e mbetjeve të materialeve nukleare,
 - shpim për furnizim me ujë,
 - me përjashtim të shpimit për hetimin e stabilitetit të tokës;
- (e) Instalime sipërfaqësore industriale për nxjerrjen e qymyrit, petroliumit, gazit natyror dhe xehroreve, si dhe të lëndëve bituminoze.

3. Industria e energjisë

- (a) Instalimet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit ose ujit të ngrohtë (projektet nuk janë përfshirë në Shtojcën I);

- (b) Instalime industriale për mbajtjen e gazit, avullit ose ujit të ngrohtë; transmetimin e energjisë elektrike nëpërmjet kabllave (projekte që nuk janë përfshirë në Shtojcën I)
- (c) Ruajtje sipërfaqësore për gazin natyror;
- (d) Ruajtje nëntokësore e gazeve të djegëshme;
- (e) Ruajtje sipërfaqësore e karburanteve fosile;
- (f) Briketimi industrial i qymyrit dhe lignitit;
- (g) Instalime për përpunimin dhe ruajtjen e mbetjeve radioaktive (në rast se nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
- (h) Instalime për prodhimin e energjisë hidro-elektrike;
- (i) Instalime për përdorimin e fuqisë së erës për prodhim energjie.

4. Prodhimi dhe përpunimi i metaleve

- (a) Instalime për prodhimin e hekurit dhe çelikut (fusion parësor ose dytësor);
- (b) Instalime për përpunimin e metaleve prej çeliku:
 - (i) mullinj të ngrohtë;
 - (ii) bluarësit me cekicë;
 - (iii) aplikimi i materialeve metalike mbrojtëse;
- (c) Fonderi ferro-metali;
- (d) Instalime për shkrirjen, duke përfshirë materialet jo prej çeliku, duke përjashtuar metalet e çmuara, duke përfshirë produktet e gjetura/zbuluara;
- (e) Instalime për trajtimin e sipërfaqeve të metaleve dhe materialeve plastike duke përdorur një proces elektrolit ose kimik;
- (f) Prodhimi i motorçikletave dhe prodhimi i motorëve për motorçikletat;

- (g) kantieret detare;
- (h) Instalime për ndërtimin dhe riparimin e avionëve;
- (i) Prodhimi i pajisjeve për hekurudha;
- (j) Instalime për pjekjen dhe sintezimin e xehroreve.

5. Industria minerale

- (a) Furra pjekëse (distilim i qymyrit të thatë);
- (b) Instalimet për prodhimin e çimentos;
- (c) Instalime për prodhimin e asbestit dhe prodhimin e produkteve të asbestos (projekte që nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
- (d) Instalime për prodhimin e qelqit, duke përfshirë dhe fibrat e qelqit;
- (e) Instalimet për shkrirjen e substancave minerale duke përfshirë dhe prodhimin e fibrave minerale;
- (f) Prodhimi i produkteve qeramike nëpërmjet djegies, në veçanti tjegullat për çati, tullat, tullat me vrima, pllakat, veshjet prej guri ose porcelani.

6. Industria kimike (Projekte që nuk janë përfshirë në Shtojcën I)

- (a) Trajtimi i produkteve ndërmjetëse dhe prodhimi i kimikateve;
- (b) Prodhimi i pesticideve dhe produkteve farmaceutike, bojrave, elastrometrave dhe peroksideve;
- (c) Ambjente ruajtëse për petroleum, prodhime petrokimike ose kimike.

7. Industria ushqimore

- (a) Prodhimi i vajrave dhe ydyrëve vegjetale dhe shtazore;
- (b) Paketimi dhe ambalazhimi i produkteve shtazore dhe vegjetale;
- (c) Prodhimi i bulmetit;
- (d) Prodhimi i ëmbëlsirave dhe i shuruprave;
- (e) Instalime për therjen e kafshëve;
- (f) Instalime për prodhime industriale;
- (g) Fabrika peshku dhe vajrash peshku;
- (h) Fabrika sheqeri.

8. Industritë tekstile, të lëkurës, leshit dhe letrës

- (a) Fabrika industriale për prodhimin e letrës dhe kartonit (projekte që nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
- (b) Impjante paratrajtimi (për veprime të tilla si larje, zbardhje, mercerizim ose lyrje fibrash ose tekstilësh);
- (c) Fabrika për ngjyrosje lëkurash;
- (d) Përpunim celuloze dhe instalime prodhimi.

9. Industria e gomës

Prodhimi dhe trajtimi i produkteve me bazë elastometri.

10. Prodhime infrastrukturore

- (a) Projekte për zhvillimin e pasurive industriale;
- (b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave blerëse dhe parkimet për makinat;
- (c) Ndërtimi i hekurudhave dhe transportit intermodal dhe i terminaleve të tilla (projekte që nuk janë përfshirë në Shtojcën I);

- (d) Ndërtim i fushave ajrore (projekte që nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
- (e) Ndërtim rrugësh, portesh dhe instalimesh për porte, duke përfshirë dhe portet e peshkimit (projekte që nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
- (f) Ndërtime në toke që nuk janë përfshirë në Shtojcën I, kanalizime dhe vepra për thithjen e ujit të shkaktuar nga përmytjet;
- (g) Diga dhe instalime të tjera të projektuara për të mbajtur ujë ose për t'a ruajtur atë në një bazë afat-gjatë (projekte që nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
- (h) Tramvaja, teleferikë dhe hekurudha nëntokësore, linja të shkëputura ose linja të ngjashme të një lloji të veçantë, të përdorura ekskluzivisht ose kryesisht për transport pasagjerësh;
- (i) Instalime tubacionesh vaji ose gazi (projekte që nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
- (j) Instalime të rezervuarve në distanca të largëta;
- (k) Punë bregdetare për të luftuar gërryerjen dhe veprat ujore që janë në gjendje që të ndryshojnë bregun gjatë ndërtimeve, për shembull të digave ose veprave të tjera për mbrojtjen nga juji, duke përfshirë dhe mirëmbajtjen dhe rindërtimin e veprave të tilla;
- (l) Nxjerrja e ujit nëntokësor dhe skemat e tjera për nxjerrjen artificiale të ujit nëntokësor të cilat nuk janë përfshirë në Shtojcën I;
- (m) Veprat për transferimin e burimeve ujore ndërmjet baseneve lumore që nuk janë përfshirë në Shtojcën I.

11. Projekte të tjera

- (a) Gara permanente dhe teste për makinat motorrike;
- (b) Instalime për shkarkimin e ujit (projekte që nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
- (c) Impjante për trajtimin e ujrave të ndotura (projekte që s`janë përfshirë në Shtojcën I);
- (d) Vende depozitimi të llumit;
- (e) Ruajtje të hekurishteve dhe të mbetjeve nga automjetet;
- (f) Teste për motorrat, turbinat ose reaguesit;
- (g) Instalime për prodhimin e fibrave minerale artificiale;
- (h) Instalime për riparimin ose shkatërrimin e substancave shpërthyes;

12. Turizmi dhe koha e lirë

- (a) Ski, dhe makineri kabllore si dhe zhvillime të tjera të ngjashme;
- (b) Marinë;
- (c) Fshatra pushimesh dhe komplekse hotelesh jashtë zonave urbane dhe zhvillimeve përkatëse
- (d) Qendra permanente kampimi dhe vende karavanësh;
- (e) Parqe tematikë.

13. — çdo ndryshim ose zgjerim i projekteve të dhëna në Shtojcën I ose në Shtojcën II, të cilat janë të autorizuara, të ekzekutuara ose në proces ekzekutimi, të cilat kanë efekte domethënëse jo të favorshme mbi mjedisin (ndryshimi ose shtrirja nuk janë përfshirë në Shtojcën I);

- Projektet në Shtojcën I të ndërmarra ekskluzivisht ose kryesisht për zhvillimin ose testimin e metodave ose produkteve të reja dhe që nuk janë përdorur për më tepër se dy vjet.

SHTOJCA III

KRITERET E PËRZGJEDHJES TË CILAVE U REFEROHET NENI 4 (3)

1. Karakteristikat e projekteve

Karakteristikat e projekteve duhet të merren parasysh duke u përqëndruar në veçanti tek:

- madhësia e projektit,
- lidhja me projekte të tjera,
- përdorimi i burimeve natyrore,
- prodhimi i mbeturinave,
- ndotja dhe acarimin,
- rreziku i aksidenteve, duke pasur parasysh në veçanti substancat dhe teknologjitë e përdorura.

2. Vendndodhja e projekteve

Ndjeshmëria mjedisore e zonave gjeografike që do të preken nga projektet duhet të merret parasysh, duke u përqëndruar kryesisht në:

- përdorimin e tokës ekzistuese,
- bollëkun, cilësinë dhe kapacitetin relativ gjenerues të burimeve natyrore në zonë,
- kapacitetin thithës të mjedisit natyror, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë fushave të mëposhtëme:
 - (a) tokave të lagura;
 - (b) zonave bregdetare;
 - (c) zonave malore dhe pyjore;
 - (d) rezervave dhe parqeve natyrore;
 - (e) zonave të klasifikuara ose të mbrojtura nën legjislacionin e Shteteve Anëtarë; zonat me mbrojtje të veçantë nga Shtetet

Anëtare në bazë të Direktivës 79/409/EEC dhe 92/43/EEC;

- (f) zonat në të cilat standardet e cilësisë mjedisore të parashtruara në legjisilacionin e Komunitetit janë tejkaluar;
- (g) zonat me densitet të lartë;
- (h) vende me domethënie historike, kulturore ose arkeologjike.

3. Karakteristikat e ndikimit të mundshëm

Efektet e mundshme domethënëse të projekteve duhet të shqyrtohen në lidhje me kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 më lart, dhe duke marrë në veçanti parasysh:

- shtrirjen e ndikimit (zonën gjeografike dhe madhësinë e popullsisë së prekur),
- natyrën ndërkufitare të ndikimit,
- shkallën dhe kompleksitetin e ndikimit,
- mundësinë e ndikimit,
- zgjatjen, frekuencën dhe efektin e ndikimit.

SHTOJCA IV
INFORMACIONI TË CILIT I REFEROHET
NENI 5 (1)

1. Përshkrimi i projektit, duke përfshirë në veçanti:

- një përshkrim të karakteristikave fizike të të gjithë projektit dhe kërkesave të përdorimit të tokës gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit,
- një përshkrim të karakteristikave kryesore të proceseve të prodhimit, për shembull, natyrës dhe cilësisë së materialeve të përdorura,
- një vlerësim, në bazë të tipit dhe masës, të mbetjeve që pritet që të gjenerohen (nga uji, ajri dhe ndotja, zhurma, dridhja, drita, ngrohja, rrezatimi, etj) që rezultojnë nga zbatimi i projektit të propozuar.

2. Një përshkrim i alternativave kryesore të studiuara nëpërmjet zhvilluesit dhe një tregues i arsyeve kryesore për këtë zgjidhje, duke marrë parasysh efektet mjedisore.

3. projektet e propozuara, duke përfshirë në veçanti popullsinë, faunën, florën, tokën, ujin, ajrin, faktorët klimaterikë, asetet materiale, duke përfshirë dhe trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike, panoramën, dhe ndërlidhjen ndërmjet faktorëve të përmendur më lart.

4. Një përshkrim³⁵ (1) të efekteve të mundshme domethënëse të projektit të propozuar mbi mjedisin, të cilat shkaktohen nga:

- ekzistenca e projektit,
- përdorimi i burimeve natyrore,
- çlirimi i ndotësve, krijimi i dëmtuesve dhe eliminimi i mbetjeve, dhe përshkrimi i

³⁵ (1) Ky vendim duhet të mbulojë efektet e drejtpërdrejta dhe ndonjë efekt jo të drejtpërdrejtë, dytësor, kumulativ, afatshkurtër, afatmesëm, afatgjatë, permanent, të përkohshëm, pozitiv dhe negativ të projektit

metodave parashikuese të përdorura për të vlerësuar efektet mbi mjedis nga zhvilluesit.

5. Një përshkrim i masave të parashikuara për të shmangur, ulur ose, aty ku është e mundur, për të eliminuar efektet jo të favorshme mbi mjedis.

6. Një përmbledhje jo teknike e informacionit të përfshirë në pjesët e mëparëshme.

7. Një tregues i vështirësive (mangësive teknike ose mungesës së njohurive teknike) i hasur nga zhvilluesi përgjatë procesit të mbledhjes së informacionit të kërkuar.

**DIREKTIVA 2001/42/EC E PARLAMENTIT
EVROPIAN DHE E KËSHILLIT**

27 qershor 2001

**mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe
programeve të caktuara mbi mjedisin**

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I
BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin që themeloi
Komunitetin Evropian, dhe në veçanti Nenin 175 ⁽³⁶⁾ të
tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit ⁽³⁷⁾,

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik
dhe Social ⁽³⁸⁾,

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit të Rajoneve
⁽³⁹⁾,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e
parashikuar në Nenin 251 të Traktatit ⁽⁴⁰⁾, në kuadrin e
tekstit të përbashkët të miratuar nga Komiteti i Pajtimit
më 21 mars 2001,

Ndërkohë që:

1. Neni 174 i Traktatit parashikon se politika e
Komunitetit mbi mjedisin është që të
kontribojë, *inter alia*, për ruajtjen, mbrojtjen
dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit,
mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe për një

³⁶ GZ C 129, 25.4.1997, f. 14 dhe GZ C 83, 25.3.1999, f. 13.

³⁷ GZ C 287, 22.9.1997, f. 101.

³⁸ GZ C 64, 27.2.1998, f. 63 dhe GZ C 374, 23.12.1999, f. 9.

³⁹ Vendimi i Parlamentit Evropian, dhënë më 20 tetor 1998
(GZ C 341, 9.11.1998, f. 18), konfirmuar më 16 shtator
1999 (GZ C 54, 25.2.2000, f. 76), Pozicioni i Përbashkët i
Këshillit, 30 mars 2000 (GZ C 137, 16.5.2000, f. 11) dhe
Vendimi i Parlamentit Evropian, 6 shtator, 2000, (GZ C
135, 7.5.2001, f. 155).

Vendimi i Parlamentit Evropian, 31 maj 2001, dhe
Vendimi i Këshillit, 5 qershor, 2001.

⁴⁰ GZ C 138, 17.5.1993, f. 5. (6) GZ L 275, 10.10.1998, f. 1.

përdorim të kujdesshëm dhe racional të burimeve natyrore, dmth bazimin mbi parimin e parakujdesit. Neni 6 i Traktatit thotë që kërkesat për mbrojtjen e mjedisit do të integrohen në përkufizimin e politikave dhe aktiviteteve të Komunitetit, në veçanti me synim nxitjen e një zhvillimi të qëndrueshëm.

2. Programi i Pestë i Veprimit mbi Mjedisin: Drejt qëndrueshmërisë — Një program i Komunitetit Evropian për politika dhe veprime në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm ⁽⁵⁾, i plotësuar nga Vendimi i Këshillit nr 2179/98/EC, i cili në rishikimin e tij afirmon rëndësinë e vlerësimit të efekteve të mundshme të planeve dhe të programeve mbi mjedisin ⁽⁶⁾.
3. Konventa mbi Diversitetin Biologjik iu kërkon Palëve që të integrojnë sa më shumë të jetë e mundur mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të diversitetit biologjik në sektorët përkatës ose në planet dhe programet ndërsektoriale.
4. Vlerësimi mjedisor është një instrument i rëndësishëm për të integruar konsiderata mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e planeve dhe të programeve të caktuara, të cilat kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin e Shteteve Anëtare, pasi nëpërmjet tij sigurohet marrja parasysh e efekteve të tilla të zbatimit të planeve dhe të programeve gjatë përgatitjes dhe përpara miratimit të tyre.
5. Miratimi i procedurave vlerësuese për mjedisin në nivelin e planifikimit dhe të programimit duhet të bëhet në mënyrë të tillë që ndërmarrësit të përfitojnë duke pasur në dispozicion një kuadër më konsistent në të cilin mund të operohet nëpërmjet përfshirjes së informacionit përkatës mjedisor në vendimmarrje. Përfshirja e një game më të gjërë faktorësh në vendimmarrje duhet të

kontribojë për zgjidhje më tepër të qëndrueshme dhe efektive.

6. Sistemet e ndryshme të vlerësimit të mjedisit që veprojnë brenda Shteteve Anëtare duhet të përfshijnë një seri kërkesash të përbashkëta proceduriale të nevojshme për të kontribuar përbnjë nivel më të lartë mbrojtje të mjedisit.
7. Kombet e Bashkuara/Komisioni Ekonomik për Konventën Evropiane mbi Vlerësimin e Ndikimit të Mjedisit në një Kontekst Ndërkufitar (25 shkurti 1991), i cili aplikohet si në Shtetet Anëtare dhe në shtetet e tjera, inkurajon palët në Konventë të zbatojnë parimet e tyre në plane dhe programe; në takimin e dytë të Palëve në Konventë, i mbajtur në Sofie më 26 dhe 27 shkurt 2001, u vendos që të përgatitej një protokoll ligjor detyrues mbi vlerësimin strategjik mjedisor, i cili do të plotësonte dispozitat ekzistuese mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor në një kontekst ndërkufitar, me synimin që ky dokument të miratohej mundësisht me rastin e Konferencës së 5-stë Ministrore “Mjedisi për Evropën”, në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve në Konventë, i planifikuar në maj 2003 në Kiev, Ukrainë. Sistemet që operojnë brenda Komunitetit për vlerësimin mjedisor të planeve dhe të programeve duhet të sigurojnë se ka konsultime të vazhdueshme ndërkufitare pasi zbatimi i një plani ose programi që përgatitet në një ndër Shtetet Anëtare ka të ngjarë që të ketë efekt domethënës mbi mjedisin e një Shtetit Anëtar. Informacioni mbi planet dhe programet që kanë ndikim të madh mbi mjedisin e Shteteve të tjera duhet të bazohet mbi bazë reciproke dhe ekuivalente brenda një kuadri ligjor të përshtatshëm ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Shteteve të tjera.
8. Si rezultat, kërkohet që merren masa në nivel Komuniteti për të përcaktuar një kuadër minimal vlerësimi mjedisor, në të cilin do të

parashtrihen parimet e përgjithshme të sistemit të vlerësimit mjedisor, detajet do t'i lihen për përcaktim Shteteve Anëtare, duke pasur parasysh parimin e subsidiaritetit. Masat e Komunitetit nuk duhet të shkojnë përtej asaj çfarë është e nevojshme për të arritur objektivat e përcaktuara në Traktat.

9. Kjo Direktivë ka natyrë procedurale dhe kërkesat e saj ose duhet të integrohen në procedurat ekzistuese të Shteteve Anëtare ose duhet të inkorporohen në procedura specifike. Me qëllim mënjanimin e përsëritjeve të vlerësimit, Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh, aty ku është e arsyeshme, faktin se vlerësimet do të bëhen në nivele të ndryshme hierarkie planesh dhe programesh.
10. Të gjithë planet dhe programet të cilat janë përgatitur për një numër sektorësh dhe të cilat përcaktojnë kuadrin për pëlqimin e zhvillimeve të ardhëshme të projekteve të dhëna në listë në Shtojcat I dhe II të Direktivës së Këshillit, nr 85/337/EEC, nxjerrë më 27 qershor 1985, mbi vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuara publike dhe private mjedisore ⁽⁴¹⁾, dhe të gjitha planet dhe programet që janë përcaktuar që të kërkojnë vlerësim në bazë të Direktivës së Këshillit 92/43/EEC, nxjerrë më 21 maj 1992, mbi mbrojtjen e habitateve natyrore dhe florës dhe faunës së egër ⁽⁴²⁾, ka të ngjarë që të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi mjedisin, dhe, si rregull, duhet të jenë subjekt i një vlerësimit mjedisor sistematik. Kur në to përcaktohet përdorimi i zonave të vogla në nivel lokal ose kur këto plane dhe programe janë modifikime të vogla të planeve ose programeve të

⁴¹ GZ L 175, 5.7.1985, f. 40. Direktiva e amenduar nga Direktiva 97/11/EC (OJ L 73, 14.3.1997, p. 5).

⁴² GZ L 206, 22.7.1992, p. 7. Direktiva e amenduar së fundmi nga Direktiva 97/49/EC (OJ L 223, 13.8.1997, f. 9).
97/62/EC (GZ L 305, 8.11.1997, f. 42).

mësipërme, ato duhet të vlerësohen vetëm nga Shtetet Anëtare nëse kanë ndikime domethënëse mbi mjedisin.

11. Plane dhe programe të tjera të cilat përcaktojnë kuadrin e pëlqimit për zhvillimin e ardhshëm të projekteve mund të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin në të gjitha rastet dhe duhet të vlerësohen vetëm kur Shtetet Anëtare të përcaktojnë se ata kanë të ngjarë që të kenë efekte të tilla.
12. Në rastet kur Shtetet Anëtare bëjnë përcaktime të tilla, ato duhet të marrin parasysh kritere të caktuara të parashikuara në këtë Direktivë.
13. Disa plane dhe programe nuk janë subjekt i kësaj Direktive si rezultat i karakteristikave të tyre të veçanta
14. Kur kjo Direktivë kërkon bërjen e një vlerësimi, do të përgatitet një raport mjedisor, ku të përfshihet informacioni i kërkuar nga Direktiva, duke identifikuar, përshkruar dhe vlerësuar efektet e mundshme mjedisore të zbatimit të planit ose programit, dhe alternativa të arsyeshme duke marrë në konsideratë objektivat dhe qëllimin gjeografik të planit ose programit; Shtetet Anëtare duhet të komunikojnë me Komisionin mbi masat e marra në lidhje me cilësinë e raporteve mjedisore.
15. Në mënyrë që të kontribohet për një vendimmarrje më transparente dhe me qëllim që të jetë e sigurtë që informacioni i dhënë për vlerësimi të jetë i kuptueshëm dhe i besueshëm, është e nevojshme që autoriteteve t'u jepen përgjegjësitë përkatëse mjedisore dhe publiku të konsultohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vlerësimit të planeve dhe programeve, si dhe të përcaktohen afate kohore të arsyeshme, duke lejuar për kohë të mjaftueshme për konsultime dhe duke përfshirë dhe shprehjen e mendimeve.

16. kur zbatimi i një plani ose programi të përgatitur nga një Shtet Anëtar ka të ngjarë të ketë një efekt domethënës mbi mjedisin e një Shteti tjetër Anëtar, duhet të bëhen parashikime për shtetet Anëtare në fjalë për të hyrë në konsultime si dhe për autoritetet dhe publikun përkatës në mënyrë që atyre t'u sigurohet e drejta e informimit dhe të jenë të lirë të shprehin mendimin e tij.
17. Raporti mjedisor dhe mendimet e shprehura nga autoritetet përkatëse dhe nga publiku, si dhe rezultatet e konsultimeve ndërkufitare duhet të merren parasysh gjatë përgatitjes së planit ose programit përpara miratimit ose dërgimit të tij për procedura legislative.
18. Shtetete Anëtare duhet të sigurohen që, kur të miratohet një plan ose program, autoritetet përkatëse dhe publiku të informohen dhe të pajisen me informacionin përkatës.
19. Kur detyrimi për të bërë vlerësimin e efekteve mbi mjedisin vjen si nga kjo Direktivë dhe nga legjislacioni i Komunitetit, si për shembull Direktiva e Këshillit 79/409/EEC e 2 prillit 1979 mbi ruajtjen e zogjve të egër⁽⁴³⁾, Direktiva 92/43/EEC, ose Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e nxjerrë më 23 tetor 2000, që përcakton një kuadër për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës së ujit⁽⁴⁴⁾, në mënyrë që të shmangen vlerësimet dyfishe, Shtetet Anëtare mund të koordinojnë ose të bashkojnë procedurat duke plotësuar kërkesat e legjislacionit përkatës të Komunitetit.
20. Raporti i parë mbi zbatimin dhe efektivitetin e kësaj Direktive duhet të bëhet nga Komisioni pesë vite pas hyrjes së në fuqi të Direktivës, dhe raportet pasuese do të dorëzohen një herë

⁴³ GZ L 103, 25.4.1979, f. 1. Direktiva e amenduar së fundmi nga Direktiva

⁴⁴ GZ L 327, 22.12.2000, f. 1

në shtatë vjet. Me qëllim që të integrohen më tej kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, dhe duke marrë parasysh eksperiencën e fituar, nëse shihet e arsyeshme, raporti i parë duhet të shoqërohet nga propozime për amendamente për këtë Direktivë, në veçanti në lidhje me mundësinë e shtrirjes së qëllimit në fusha/sectorë të tjerë dhe në lloje të tjera planesh dhe programesh.

MIRATUAN KËTË DIREKTIVË:

Neni 1. Objektivat

Objektivi i kësaj Direktive është që të ofrojë një nivel të lartë mbrojtjeje mjedisi dhe të kontribuojë për integrimin e masave për ruajtjen e mjedisit gjatë përgatitjes dhe miratimit të planeve dhe të programeve, me qëllim nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, duke siguruar që, në përputhje me këtë Direktivë, të bëhet një vlerësim mjedisor i planeve dhe programeve të caktuara, të cilat ka të ngjarë që të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi mjedis.

Neni 2. Përkufizime

Në kuptimin e kësaj Direktive:

- (a) ‘planet dhe programet’ janë planet dhe programet, ku përfshihen dhe planet dhe programet e bashkë-financuara nga Komunitetit Evropian, si dhe çdo modifikim i tyre:
- të cilat janë subjekt i përgatitjes dhe/ose miratimit nga një autoritet në nivelin rajonal ose vendor, ose të cilat janë përgatitur nga një autoritet për miratim, nëpërmjet një procedure legislative, nga parlamenti ose Qeveria, dhe
 - të cilat kërkohen nga dispozitat legislative, rregullatore dhe administrative;

- (b) ‘vlerësimi mjedisor’ është përgatitja e një raporti mjedisor, përgatitja e konsultimeve, dhe marrja parasysh e raportit mjedisor dhe e rezultateve të konsultimeve, marrja parasysh e raportit mjedisor dhe rezultatet e konsultimeve në vendimmarrje dhe dispozitat e informacionit mbi vendimin në përputhje me Nenin 4 – 9;
- (c) ‘raporti mjedisor’ është pjesa e dokumentacionit të planit ose programit që përmban informacionin që kërkohet në Nenin 5 dhe në Shtojcën I;
- (d) ‘publiku’ përfaqëon një ose më shumë persona fizikë ose juridikë dhe, në përputhje me legjislacionin ose praktikën kombëtare, shoqatat, organizatat ose grupet e tyre.

Neni 3. Qëllimi

1. Vlerësimi mjedisor, në përputhje me Nenin 4-9, do të bëhet për plane dhe programe të cilave u referohen paragrafët 2 – 4, kur këto plane ose programe ka të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin.
2. Në bazë të paragrafit 3, një vlerësim mjedisor do të bëhet për të gjitha planet dhe programet,
 - (a) të cilat janë përgatitur për fushat e bujqësisë, pyjeve, peshkimit, energjisë, transportit, industrisë, menaxhimit të mbetjeve, menaxhimit të ujit, telekomunikacioneve, turizmit, planifikimit të qyteteve dhe fshatrave ose përdorimit të tokës, të cilat përcaktojnë kuadrin për pëlqimin e zhvillimit në të ardhmen të projekteve të cilat jepen në Shtojcën I dhe II të Direktivës 85/337/EEC, ose
 - (b) të cilat, në kuadrin e efekteve të mundshme mbi zona, janë përcaktuar si plane dhe programe që duhet të bëjnë një vlerësim në bazë të Nenit 6 ose 7 të Direktivës 92/43/EEC.
3. Planet dhe programet të cilave u referohet paragrafi 2, të cilat përcaktojnë përdorimin e zonave të vogla në nivel vendor dhe modifikime të vogla planesh ose programesh që përmenden në paragrafin 2 do t’u

kërkohet të bëjnë vlerësimin mjedisor vetëm në rastet kur Shtetet Anëtare përcaktojnë se ato mund të kenë efekte të konsiderueshme mbi mjedisin.

4. Shtetet Anëtare do të përcaktojnë nëse planet dhe programet që përcaktojnë kuadrin për pëlqimin e zhvillimit të projekteve të ardhëshme, të ndryshme nga planet dhe programet të dhëna në paragrafin 2, ka të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin.

5. Shtetet Anëtare do të përcaktojnë nëse planet dhe programet të cilëve u referohen paragrafët 3 dhe 4 kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mjedisore ose nëpërmjet shqyrtimeve rast-pas-rasti ose nëpërmjet specifikimeve të llojit të planeve dhe programeve ose duke kombinuar të dyja këndvështrimet. Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare në të gjitha rastet do të marrin parasysh kriteret përkatëse të përcaktuara në Shtojcën II, në mënyrë që të sigurohet që planet dhe programet që mund të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin mbulohen nga kjo Direktivë.

6. Autoritetet të cilave u referohet nenin 6(3) do të konsultohen në shqyrtimin rast pas rasti dhe në llojet specifike të planeve dhe programeve, në përputhje me paragrafin 5.

7. Shtetet Anëtare do të sigurohen që konkluzionet e tyre, në bazë të paragrafit 5, duke përfshirë dhe arsyet për mos kërkimin e një vlerësimi mjedisor në bazë të Neneve 4-9, do t'i bëhen me dije publikut.

8. Planet dhe programet e mëposhtëme nuk janë subjekt i kësaj Direktive:

- planet dhe programet qëllimi i vetëm i të cilave është që të shërbejnë për sigurinë kombëtare dhe emergjencat civile;
- planet ose programet financiare ose buxhetore.

9. Kjo Direktivë nuk aplikohet për plane dhe programe të bashkëfinancuara nën perspektivën aktuale të periudhave të programimit⁴⁵ (1) për Rregulloret e

⁴⁵ (1) Periudha e programimit 2000-2006 për Rregulloren e Këshillit (EC) nr 1260/1999 dhe periudhat e programimit

Këshillit (EC) nr 1260/1999⁴⁶ (2) dhe (EC) nr 1257/1999⁴⁷ (3).

Neni 4. Detyrime të Përgjithshme

1. Vlerësimi mjedisor të cilit i referohet Neni 3, do të bëhet gjatë përgatitjes së planit dhe programit dhe përpara miratimit dhe dërgimit të tij për procedura legjislative.
2. Kërkesat e kësaj Direktive ose do të integrohen në procedurat ekzistuese të Shteteve Anëtare për miratimin e planeve dhe programeve ose do të inkorporohen në procedurat e përcaktuara për t'u përputhur me këtë Direktivë.
3. Në rastet kur planet ose programet formojnë pjesë të një hierarkie, Shtetet Anëtare, me qëllim mënjanimin e përsëritjeve të vlerësimit, do të marrin në konsideratë faktin që vlerësimi do të bëhet në përputhje me këtë Direktivë, në nivele të ndryshme hierarkie. Inter alia, me synimin e shmangies së përsëritjeve, Shtetet Anëtare do të aplikojnë Nenet 5(2) dhe (3).

Neni 5. Raporti Mjedisor

1. Në rastet kur kërkohet një vlerësim mjedisor sipas Nenit 3(1), do të përgatitet një raport mjedisor, në të cilin do të përfshihen efektet e mundshme mbi mjedisin gjatë zbatimit të planit ose programit, dhe alternativat e arsyeshme duke marrë parasysh objektivat dhe qëllimin

2000-2006 dhe 2000-2007 për Rregulloren e Këshillit (EC) nr 1257/1999.

⁴⁶ (2) Rregullorja e Këshillit (EC) nr 1260/1999, e nxjerrë më 21 qershor 1999, që parashikon dispozita të përgjithshme mbi Fondet Strukturore (GZ L 161, 26.6.1999, f. 1).

⁴⁷ (3) Rregullorja e Këshillit (EC) nr 1257/1999, nxjerrë më 17 maj 1999, mbi mbështetjen për zhvillim rural nga Fondi Bujqësor Evropian Udhëzues dhe Garantues (European Agricultural Guidance and Guarantee Fund (EAGGF)) dhe amendimi dhe heqja e disa rregullave (GZ L 160, 26.6.1999, f. 80).

gjeografik të planit ose programit. Informacioni që do të jepet për këtë qëllim është pjesë e Shtojcës I.

2. Raporti mjedisor i përgatitur në përputhje me paragrafin 1 do të përfshijë informacionin që mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme, duke marrë parasysh njohuritë aktuale dhe metodat e vlerësimit, përmbajtjen dhe nivelin e detajeve në plan dhe në program, nivelin e tyre në procesin vendimmarrës dhe masën në të cilën çështje të caktuara vlerësohen në mënyrë më të drejtë në nivele të ndryshme në proces, në mënyrë që të shmangen vlerësimet e dyfishtat.

3. Informacioni i disponueshëm mbi efektet e planeve dhe programeve mbi mjedisin, i marrë nga nivele të tjera vendimmarrëse ose nëpërmjet legjislationeve të tjera Komunitare, mund të përdoret për të dhënë informacionin të cilit i referohet Shtojca I.

4. Autoritet të cilave u referohet Neni 6(3) do të konsultohen kur të merret vendimi për qëllimin dhe nivelin e detajeve të informacionit i cili duhet të përfshihet në raportin mjedisor.

Neni 6. Konsultimet

1. Projekt plani ose programi dhe raporti mjedisor i përgatitur në përputhje me Nenin 5 do të bëhet i disponueshëm për autoritetet e përmendura në paragrafin 3 të këtij Neni dhe për publikun.

2. Autoriteteve të përmendura në paragrafin 3 dhe publikut të përmendur në paragrafin 4 do t'u jepet një mundësi efektive dhe e hershme në kohë që brenda afateve kohore të përcaktuara të shrehin mendimin e tyre për projekt planin ose programin dhe për raportin shoqërues mjedisor përpara hartimit të planit ose programit ose përpara dorëzimit të tyre për procedura legjislative.

3. Shtetet Anëtare do të përcaktojnë autoritetet që do të konsultohen, të cilat, si rezultat i përgjegjësive mjedisore, ka të ngjarë që të shqetësohen/preken nga efektet mjedisore të planeve ose programeve zbatuese.

4. Shtetet Anëtare do të identifikojnë publikun për qëllim të paragrafit 2, duke përfshirë publikun e prekur ose që ka të ngjarë të preket nga, ose që është i interesuar në vendimmarrjen që është subjekt i kësaj Direktive, duke përfshirë dhe organizata jo-qeveritare përkatëse, si për shëmbull organizatat që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe organizata të tjera të interesuara.

5. Rregullimet e detajuara për informacion dhe konsultim nga autoritetet dhe publiku do të përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

Neni 7. Konsultime Ndërkufitare

1. Në rastet kur një Shtet Anëtar e konsideron zbatimin e një plani ose programi që po përgatitet në territorin e tij ndikues mbi mjedisin e një Shteti tjetër Anëtar, ose kur kërkohet prej një Shteti Anëtar të prekur nga plani ose programi, Shteti Anëtar në territorin e të cilit përgatitet plani ose programi, përpara miratimi ose dorëzimit të dokumentave për procedura legjislative, do t'i dorëzojë Shtetit tjetër Anëtar një kopje të projekt-planit ose programit si dhe raportin përkatës mjedisor.

2. Kur, sipas paragrafit 1, një Shtet Anëtar i dërgohet një kopje e një draft-planit ose programi i një raporti mjedisor, ai duhet të njoftojë Shtetin tjetër Anëtar nëse është i interesuar të hyjë në konsultime përpara miratimit të planit ose programit, ose përpara dërgimit të dokumentave për procedura ligjore, dhe nëse është i interesuar, Shteti Anëtar i prekur do të hyjë në konsultime për efektet e mundshme ndërkufitare që do të shkaktohen nga zbatimi i planit ose programit dhe masat e parashikuara për të eliminuar efekte të tilla.

Në rastet kur ndodhin konsultime të tilla, Shtetet Anëtare në fjalë do të bien dakort për detajet për të siguruar që autoritetet e përmendura në Nenin 6(3) dhe publiku i përmendur në Nenin 6(4) në Shtetin Anëtar që ka të gjarë të preket nga plani/programi të informohen dhe t'u jepet mundësia që të shprehin mendimin e tyre brenda një kohe të arsyeshme.

3. Kur, sipas këtij Neni, Shtete Anëtare u kërkohet që të hyjnë në konsultime, ata duhet të bien dakort në fillim të konsultimeve për kohëzgjatjen e bisedimeve.

Neni 8. Vendimmarrja

Raporti mjedisor i përgatitur në përputhje me Nenin 5, mendimet e shprehura në bazë të Nenit 6 dhe rezultatet e konsultimeve ndërkufitare të realizuara në bazë të Nenit 7 do të merren parasysh gjatë përgatitjes së planit ose programit përpara miratimit ose dorëzimit për procedura legjislative.

Neni 9. Informacion mbi vendimin

1. Shtetet Anëtare do të sigurohen që kur të miratohet një plan ose program, autoritetet që përmenden në Nenin 6(3), publiku ose çdo Shtet Anëtar që konsultohet në bazë të Nenit 7 të informohen dhe çështjet e mëposhtëme t'u bëhen me dije palëve të përmendura:

- (a) plani ose programi i miratuar;
- (b) një deklaratë ku përmbliidhen konsideratat mjedisore të përfshira në plan ose program dhe mënyra e përgatitjes së raportit mjedisor në bazë të Nenit 5, mendimet e shprehura në bazë të Nenit 6 dhe rezultatet e konsultimeve të bëra në bazë të Nenit 8, si dhe arsyet për zgjedhjen e planit ose programit të miratuar, në duke përmendur dhe alternativave të tjera të mundshme të diskutuara, dhe
- (c) masat e vendosura në lidhje me monitorimin, në përputhje me Nenin 10.

2. Rregullimet e detajuara në lidhje me informacionin të cilit i referohet paragrafi 1 do të përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

Neni 10. Monitorimi

1. Shtetet Anëtare *inter alia* do të monitorojnë efektet e mundshme domethënëse mbi mjedis gjatë zbatimit të

planeve dhe programeve, në mënyrë që të identifikohen që në një etapë të hershme efektet negative të paparashikuara, dhe që merren masa ndreqëse në kohë.

2. Në mënyrë që të krijohet përputhshmëri me paragrafin 1, kur të gjykohet e nevojshme do të mund të përdoren rregullime ekzistuese monitoruese, me qëllim që të shmangen monitorimet e dyfishta.

Neni 11. Marrëdhënia me Pjesën Tjetër të Legjislacionit Komunitar

1. Vlerësimi mjedisor i realizuar sipas parashikimeve të kësaj Direktive do të bëhet në përputhje me çdo kërkesë të parashikuar në Direktivën 85/337/EEC dhe ligjet e Komunitetit.

2. Për planet dhe programet për të cilat detyrimi për të bërë vlerësime për efektet mbi mjedisin rrjedh si nga kjo Direktivë dhe nga legjislacioni i Komunitetit, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë procedura të koordinuara ose të përbashkëta për të plotësuar kërkesat e legjislacionit përkatës të Komunitetit, *inter alia*, për të shmangur përsëritjen e vlerësimit.

3. Për plane ose programe të bashkëfinancuara nga Komuniteti Evropian, vlerësimi mjedisor, sipas kësaj Direktive, do të bëhet në përputhje me dispozitat e veçanta përkatëse të legjislacionit të Komunitetit.

Neni 12. Informacioni, raportimi dhe rishikimi

1. Shtetet Anëtare dhe Komisioni do të shkëmbejnë informacion mbi eksperiencën e marrë gjatë aplikimit të kësaj Direktive.

2. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që raportet mjedisore të jenë të një cilësie mjaftueshmërisht të mirë për të plotësuar kërkesat e kësaj Direktive dhe do të njoftojnë Komisionin për masat e marra në lidhje me cilësinë e këtyre raporteve.

3. Përpara 21 qershorit 2006, Komisioni do t'i dërgojë Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport të parë mbi aplikimin dhe efektivitetin e kësaj Direktive.

Me qëllim integrimin e kërkesave të mbrojtjes së mjedisit, në përputhje me Nenin 6 të Traktatit, dhe duke marrë parasysh eksperiencën e marrë gjatë aplikimit të Direktivës në Shtetet Anëtare, një raport i tillë do të shoqërohet nga propozime për amendime të Direktivës, nëse diçka e tillë shihet e arsyeshme. Në veçanti, Komisioni do të marrë parasysh mundësinë e shtrirjes së qëllimit të Direktivës në fusha/sectorë të tjerë dhe në lloje të tjera planesh dhe programesh.

Në intervale shtatë vjeçare do të dorëzohen raporte të reja vlerësimi.

4. Komisioni do të raportojë mbi marrëdhënien ndërmjet Direktivës dhe Rregulloreve (EC) nr 1260/1999 dhe (EC) nr 1257/1999 përpara skadimit të periudhave të programimit të parashikuara në këto Rregullore, me qëllim sigurimin e një përjasjeje koherente në lidhje me këtë Direktivë dhe Rregulloret pasuese të Komunitetit.

Neni 13. Zbatimi i Direktivës

1. Shtetet Anëtare do të miratojnë ligje, rregullore dhe dispozita administrative të nevojshme për të siguruar përputhshmëri me këtë Direktivë përpara 21 qershorit 2004. Ata si rrjedhim do të informojnë Komisionin për të gjitha ndryshimet e bërë në këtë drejtim.

2. Kur Shtetet Anëtare të miratojnë masat, ato duhet të përfshijnë një referencë në Direktivë, ose duhet të shoqërohen nga një referencë e re me rastin e botimit të tyre zyrtar. Metodatat e bërjes së referencave të tilla do të përcaktohet nga Shtetet Anëtare.

3. Detyrimi që rrjedh nga Neni 4(1) do të aplikohet për planet dhe programet për të cilat akti i parë zyrtar parapërgatitor vjen pas datës së përmendur në paragrafin 1. Planet dhe programet, akti i parë zyrtar parapërgatitor i të cilëve kërkohet përpara datës së dhënë në paragrafin 1 dhe të cilat janë miratuar ose dorëzuar për procedura legjislativë më shumë se 24 muaj më vonë do të jenë subjekt i parashikimeve të dhëna në Nenin 4(1), në përjashtim të rasteve kur Shtetet Anëtare përcaktojnë mbi bazë rasti se një gjë e

tillë nuk është e përshtatshme dhe informojnë publikun për vendimin e marrë.

4. Përpara 21 qershorit 2004, përveç masave të cilave u referohet paragrafi 1, Shtetet Anëtare do t'i komunikojnë Komisionit informacion të veçantë mbi llojet e planeve dhe programeve, i cili, në përputhje me Nenin 3, do të jetë subjekt i vlerësimit mjedisor në bazë të kësaj Directive. Komisioni do t'ia transmetojë këtë informacion Shteteve Anëtare. Informacioni do të përditësohet rregullisht.

Neni 14. Hyrja në Fuqi

Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 15

Kjo Direktivë i drejtohet Shteteve Anëtare.

E bërë në Luksemburg, më 27 qershor 2001.

Për Parlamentin Evropian
Presidenti
N. FONTAINE

Për Këshillin
Presidenti
B. ROSENGREN

SHTOJCA I

Informacioni i Përmendur në Nenin 5(1)

Informacioni që parashikohet në Nenin 5(1), që është subjekt i Nenit 5(2) dhe (3), është informacioni i mëposhtëm:

- (a) një përshkrim i përmbajtjeve, objektivave kryesore të planit ose programit dhe marrëdhënieve me plane ose programe të tjera;

- (b) aspektet përkatëse të gjendjes aktuale të mjedisit zhvillimi i ngjashëm për zbatimin e planit ose programit;
- (c) karakteristikat mjedisore të zonave që mund të preken konsiderueshëm;
- (d) problemet ekzistuese mjedisore që lidhen me planin ose programin, duke përfshirë në veçanti problemet që lidhen me zona të një rëndësie të veçantë mjedisore, si për shembull zonat e projektuara sipas Direktivave 79/409/EEC dhe 92/43/EEC;
- (e) objektivat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në shkallë ndërkombëtare, nivel Komuniteti ose Shteti Anëtar, të cilat lidhen me planin ose programin dhe mënyra në të cilën këto objektiva ose konsiderata mjedisore janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së planeve dhe programeve;
- (f) efektet më të rëndësishme të mundshme⁴⁸ (1) mbi mjedis, duke përfshirë dhe çështje të tjera si biodiversiteti, popullsia, shëndeti i njerëzve, fauna, flora, toka, uji, ajri, faktorët klimaterikë, asetet materiale, trashëgimia kulturore duke përfshirë trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike, pamjen dhe ndërlidhjen ndërmjet faktorëve të mësipërm;
- (g) masat e parashikuara për të shmangur, ulur dhe për të zhdukur sa më shumë të jetë e mundur efektet domethënëse negative mbi mjedis gjatë zbatimit të planit ose programit;
- (h) një përshkrim të arsyeve për përzgjedhjen e alternativave të trajtuara, dhe një përshkrim të mënyrës sesi u realizua vlerësimi, duke përfshirë vështirësitë (si për shembull mangësitë teknike ose mungesa e njohurive teknike) të hasura gjatë përgatitjes së informacionit të kërkuar;

⁴⁸ (1) Këto efekte duhet të përfshijnë efekte sekondare, kumulative, sinergjike, afat-shkurtëra, afat-mesme, afat-gjata, të përkohshme, positive dhe negative.

- (i) një përshkrim të masave të parashikuara për monitorimin, sipas Nenit 10;
- (j) një përmbledhje jo teknike të informacionit të dhënë nën kategoritë e mësipërme.

SHTOJCA II

Kriteret për përcaktimin e domëthënies së mundshme të efekteve të parashikura në Nenin 3 (5)

1. Karakteristikat e planeve dhe të programeve, duke pasur parasysh në veçanti:

- shkallën në të cilën një plan ose program përcakton kuadrin e projekteve dhe të aktiviteteve të tjera, ose lidhja e tyre me vendndodhjen, natyrën, madhësinë dhe kushtet operuese ose me burimet e përcaktuara,
- shkallën në të cilën plani ose programi influencën plane dhe programe të përfshira dhe ato në hierarki,
- lidhjen e planit ose programit për integrimin e konsideratave mjedisore në veçanti në lidhje me promovimin e një zhvillimi të qëndrueshëm,
- probleme mjedisore që lidhen me planin ose programin,
- përputhshmërinë e një plani ose programi për zbatimin e legjislacionit të Komunitetit mbi mjedisin (psh planet dhe programet e lidhura me menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e ujit).

2. Karakteristika të efekteve dhe të zonave që ka të ngjarë të ndikohen, duke pasur parasysh, në veçanti

- Probabilitetin, kohëzgjatjen, frekuencën dhe natyrën e efekteve,

- Natyrën kumulative të efekteve,
- Natyrën ndërkufitare të efekteve,
- Rrezikun e shëndetit të njeriut mbi mjedis (psh si shkak i aksidenteve),
- Shkallën dhe shtrirjen hapsinore të efekteve (zona gjeografike dhe madhësia e popullsisë që mund të preken),
- Vlerën dhe cënueshmërinë e zonës që ka të ngjarë të ndikohet si rezultat i:
 - karakteristikave të veçanta natyrore ose trashëgimisë kulturore,
 - standardeve mjedisore të tepërta dhe vlerave limit,
 - përdorimit intensiv të tokës,
- Efektet mbi zonat ose sipërfaqet që kanë një status të njohur kombëtar, Komunitar ose ndërkombëtar mbrojtës.